RAPORTI I PUNËS
2024

PËRMBAJTJA

HYRJE 3
PUBLIKOHET LISTA E KOMBËTARES U18 (VAJZAT) 4
DJEMTË U18, PËRGATITEN PËR KUALIFIKIME 5
BËHET PUBLIKE LISTA E U20 TE VAJZAT 6
KATEGORIZIMI: VOLEJBOLLI NË GRUPIN A 7
DIPLOMATËT E KOSOVËS NË MBËSHTETJE TË KOMBËTARES 8
KOSOVA KALON TUTJE PA LOJË, SERBIA NUK PARAQITET 9
KOSOVA ME PARAQITJEN MË TË MIRË TË GARËS 10
MBYLLET AFATI KALIMTAR I JANARIT, 29 KËRKESA 11
GJINOVCI E NIKÇI NË ASAMBLENË E BVA-së 12
BAJRAMI E KRASNIQI SHPRESA OLIMPIKE 13
ZV.MINISTRJA OSMANI VIZITË NË FVK - NËNSHKRUHET MEMORANDUMI 14
RAIFFEISEN SUPERLIGA A • NË FUNDJAVË FILLON SEZONI PRANVEROR 15
AKTIVITET I VOLEJBOLLIT NË MALISHEVË 16
TURNEU PAVARËSIA NË GJAKOVË 17
SUPERLIGA B, ORARI DHE NDESHJET 18
LIGA E PARË • ORARET DHE NDESHJET 19
SHORTI • KUPA E KOSOVËS 2024 20
SHORTI • KUPA E KOSOVËS 2024 21
LIGA GJERGJ KASTRIOTI- GJYSËMFINALET 22
MBYLLET LIGA GJERGJ KASTRIOTI, NDEROHET PRESIDENTI GJINOVCI 23
ILAZI E HAXHIKADRIJA PJESË E KAMPIT NË ITALI 25
FVK I FITON 3 PROJEKTE TË REJA NGA FIVB 26
SHORT I VËSHTIRË NË KUALIFIKIMET E CEV EUROVOLLEY 27
FVK E FITON TË DREJTËN E ORGANIZIMIT TË KURSIT TË TRAJNERËVE - NIVELI 2 28
KV VËLLAZNIMI KAMPION I LIGËS SË PARË (F) PERËNDIM 29
PRISHTINA KAMPION I SUPERLIGËS B (DJEMTË) 30
MBAHET KUVENDI I PUNËS I FVK-së 31
KV TREPÇA KAMPION I LIGËS 1 (LINDJE) 32
KOMBËTARJA U20 (VAJZAT) PËRGATITET PËR CEV EUROVOLLEY 33

KUPA E KOSOVËS • REZULTATET E GJYSMËFINALEVE 34
KV PEJA E FITON KUPËN E KOSOVËS 35
KV DRITA E FITON KUPËN E KOSOVËS 2024 36
KV FERIZAJ PROMOVOHET NË RAIFFEISEN SUPERLIGËN A 37
KOSOVA U20 E ZHVILLON STËRVITJEN E PARË NË SLLOVAKI 38
KOMBËTARJA U18 NË PËRGATITJE INTENZIVE PARA KUALIFIKIMEVE 39
KOSOVA U20 I MBYLLI KUALIFIKIMET PËR CEV EUROVOLLEY 40
RAIFFEISEN SUPERLIGA A (DJEMTË) 41
KOSOVA U18 GATI PËR KUALIFIKIMET E CEV EUROVOLLEY 42
GJAKOVA I PRET KUALIFIKIMET E CEV EUROVOLLEY 43
KOMBËTARJA U18 ARRIN NË ITALI, TË PREMTEN NISIN KUALIFIKIMET 44
RAIFFEISEN SUPERLIGA A (VAJZAT) 45
KV PEJA NË FINALE TË PLAY OFF-it 46
PRISHTINA ELITE PROMOVOHET NË SUPERLIGËN B 47
KV GJINOCI RIKTHEHET NË RAIFFEISEN SUPERLIGËN A 48
GOLDEN EAGLE THERANDA MBETET NË RAIFFEISEN SUPERLIGËN A 49
KV ULPIANA MBETET NË RAIFFEISEN SUPERLIGËN A 51
PEJA - SKËNDERBEU, FINALJA E PARË 52
DRITA E SKËNDERAJ, SERIA E FINALEVE NGA E DIELA 53
PEJA E FITON FINALEN E PARË 54
PLAY-OFF I GRUPMOSHËS U18 55
DY KLUBE TË REJA NË SKENËN E VOLEJBOLLIT 56
SUPER SUKSES I ADRIATIK KAJTAZIT 57
BURIM ZYMERI GJYQTAR ME THIRRJE NDËRKOMBËTARE 58
PEJA TRIUMFON NË LIPJAN, AVANSON 2-0 NË FINALE 59
GARAT U16 60
SKENDERAJ E FITON FINALEN E TRETË 61
GE THERANDA KAMPION I U18 62
VAJZAT E SUTI SPORT KAMPIONE U18 63
PEJA E FITON TITULLIN E SHTATË 64
MBYLLET KAMPIONATI U22 NË BEACH VOLLEY 65

HYRJE

Fillimi i vitit 2024 ishte mjaft dinamik, ku tri kombëtaret e grupmoshave filluan përgaditjet për pjesëmarrje në Kualifikimet për Kampionatin Evropian U18 dhe U20. Këto kualifkime fillimisht u organizuan në kuadër të Federatës Ballkanike të volejbollit BVA.

Kombëtaret U18 meshkuj dhe femra dhe kombëtarja U20 femra, ishin pjesëmarrëse në këto gara. Vajzat U18 garat kualfikuese i zhvilluan në Bullgari, ndërsa meshkujt U18 në Maqedoninë e Veriut. Femrat U20 këto kualfikime i zhvilluan në Turqi. Të gjitha kombëtaret u kualifikiuan në fazën e dytë, ku Kosva ishte nikoqire e CEV European Championship U18 meshkujt e cila u organizua në Gjakovë, femrat U18 fazen e dytë e zhvilluan në Itali ndërsa femrat U20 në Sllovaki.

Volejbolli ka vazhduar me rritjen e performancës duke u kategorizuar në grupin A të sporteve edhe për vitin 2024. Pavarësisht se kishte ndryshim të rregullores dhe këtë vitë nuk ishte e lehtë arritja e pikëve Volejbolli ishte ndër tre sportet e kategorizuar në kategorinë A.

Padyshim që liga “Gjergj Kastrioti” ishte një nga aktivitetet e rëndësishme të FVK-së, për vitin 2024. Këtë vit gara u zhvillua në një format tjetër me pjesëmarrje më të madhe të ekipeve. Finalet u zhvilluan në Korçë në një atmosferë mjaft interesante.

Organizimi i garave të grupmoshave në format tjetër duke u dhënë më shumë mundësi për më shumë ndeshje grupmoshave ishte një risi tjetër për dallim nga vitet e kaluara. Pastaj garat e beach volley U18,U20, U22 dhe senior për të dyja gjinitë me pjesëmarrje massive të ekipeve.

Një tjetër ngjarje me rëndësi që ka karakterizuar vitin 2024 ishte fillimi i implementimit të bashkëpunimit të FVK me Fedraten Italiane të Volejbollit – FIPAV. Këtë vit kanë filluar vizitat e trajnerëve kosovar nëpër kampet e kombëtareve italiane.

Ngjarja më e rëndësishme e vitit 2024 padyshim që është pjesëmarrja në kualfikimet për Kampionatin Evropian CEV Euro Volley 2026 me kombëtaret seniore meshkuj dhe femra. Ndeshjet në kuadër të këtyre kualfikimeve pritet të zhvillohen edhe gjatë vitit 2025.

PUBLIKOHET LISTA E KOMBËTARES U18 (VAJZAT)

3 Janar, 2024

Përzgjedhësi Berat Husaj e ka bërë publike listën e vajzave të ftuara për sfidat e fillimvitit.

Kosova do jetë pjesë e grupit A, në kualifikimet për CEV EuroVolley U18 së bashku me Bullgarinë e Rumaninë.

Ndeshjet e këtij raundi kualifikues zhvillohen në Sofje të Bullgarisë.

Vajzat e ftuara do të fillojnë grumbullimin nga data 7 janar 2024, në Skenderaj.



DJEMTË U18, PËRGATITEN PËR KUALIFIKIME

3 Janar, 2024

"Dardanët" e grupmoshës U18 e kanë mësuar listën e saktë të të ftuarve, për kualifikimet e CEV EuroVolley U18.

Kjo grupmoshë e drejtuar nga përzgjedhësi Blendi Haxhikadria, do të garojë në grupin A të kualifikimeve, së bashku me Greqinë dhe Maqedoninë e Veriut.

Ndeshjet e këtij turneu kualifikues do të zhvillohen nga 18-20 janar 2024 në Strumicë të Maqedonisë së Veriut.

Kombëtarja U18 te djemtë, do të grumbullohet nga data 7 janar 2024 në Gjakovë, për përgatitje intenzive.



BËHET PUBLIKE LISTA E U20 TE VAJZAT

3 Janar, 2024

Strategu turk Ali Bahadur Aksoy, i cili e udhëheq Kombëtaren U20 te vajzat, e ka publikuar listën finale, për kualifikimet e CEV EuroVolley 2024.

Kualifikimet që zhvillohen nga 23-25 janar 2024 në Ankara të Turqisë, e gjejnë Kosovën në grup aspak të lehtë me Turqinë si vendas dhe Rumaninë.

Pikërisht përballë rumuneve, vajzat tona do ta zhvillojnë sfidën e parë më 24 janar 2024, kurse një ditë më vonë luajnë kundër Turqisë.

Kombëtarja U20 te vajzat do të grumbullohet fillimisht në Skenderaj, e pastaj do të vazhdojë ciklin e grumbullimit edhe në Prishtinë.



KATEGORIZIMI: VOLEJBOLLI NË GRUPIN A

19 Janar, 2024

Federata e Volejbollit e Kosovës, është në mesin e tri Federatave të mbetura në grupin A, të procesit të kategorizimit.

Ky proces, që sivjet për herë të parë u realizua nga MKRS, sipas vlerësimit paraprak, e ka rënditur FVK-në në mesin e Federatave të Grupit A, që është niveli më i lartë.

FVK sipas vlerësimit të komisionit përkatës, i ka tubuar 85,2 pikë.

Mbetja në Grupin A, reflekton punën e mirë që është bërë në segmentet me rëndësi, të cilat janë kriter në vlerësim.

Shtëpia kosovare e volejbollit, i falënderon të gjithë ata që janë pjesë e komunitetit tonë, e pa të cilët nuk do të ishte i mundur ky sukses.

Faleminderit gjithë familjes së madhe të volejbollit, partnerëve e bashkëpunëtorëve, që janë pjesë e jona.

Së bashku, vazhdojmë drejt shtigjeve të reja.



DIPLOMATËT E KOSOVËS NË MBËSHTETJE TË KOMBËTARES

20 Janar, 2024

Diplomatët e Ambasadës së Republikës së Kosovës në Sofje, Bujar Deskaj e Bekim Misini e kanë ndjekur nga afër ndeshjen në mes përfaqësueses së Kosovës U18 në volejboll kundër moshatareve të Turqisë, e vlefshme për ciklin kualifikues CEV U18 Kualifikimet për EuroVolley (vajzat). FVK i falënderon diplomatët kosovarë për mbështetjen e dhënë për Kombëtaren tonë.

Ndeshja u zhvillua në qendrën sportive “Hristo Botev” në Sofje.



KOSOVA KALON TUTJE PA LOJË, SERBIA NUK PARAQITET

21 Janar, 2024

Kosova U18 (djemtë) e ka fituar ndeshjen në tavolinë ndaj Serbisë U18, pasi kundërshtari nuk u paraqit. Arsyeja zyrtare e ekipit serb, ka qenë se "9 lojtarë të formacionit të Serbisë kanë qenë me temperaturë, duke u pamundësuar daljen në teren".

Duke e patur parasysh çasjen refuzuese të Serbisë ndaj shtetësisë së Kosovës, FVK e konsideron të paqëndrueshëm arsyetimin e dhënë nga Federata Serbe e Volejbollit dhe do të kërkojë nga CEV, që Serbia të sanksionohet për këtë veprim.

FVK më shumë do t'i gëzohej suksesit të arritur në arenën sportive, sesa rezultateve të vendosura "në tavolinë".

Kombëtarja jonë u paraqit në fushë, tregoi pjekuri për lakmi dhe nivel të lartë të profesionalizmit.

Djemve tanë iu mohua gara kompetitive, meqë kundërshtari nuk u shfaq në teren.

Sporti duhet të krijojë ura bashkimi, e Serbia në këtë rast ka dëshmuar përmes veprimeve të kësaj natyre, se akoma nuk e ka këtë vullnet e gadishmëri.

U mbetet mekanizmave brenda BVA dhe CEV, që ta hulumtojnë këtë veprim, për të cilin, bazuar nga hapat e ngjajshëm edhe në të kaluar, nënkuptohet si tendencë për ta shmangur duelin me Kosovën.

FVK e uron shtabin teknik dhe djemtë e Kombëtares U18, për paraqitjen dinjitoze dhe kalimin në fazën e mëtutjeshme të CEV U18 EuroVolley.



KOSOVA ME PARAQITJEN MË TË MIRË TË GARËS

27 Janar, 2024

Kosova U20 e ka mbyllur kampanjën kualifikuese për CEV EuroVolley, me paraqitjen më të mirë, të regjistruar të shtunën ndaj Malit të Zi.

Kombëtarja jonë pavarësisht se u gjend në disavantazh pas humbjes së setit të parë (25:17), në të dytin u rikthye duke e fituar 25:22.

Kjo e futi në presion Malin e Zi, derisa volejbollisteet e Kosovës në setin e tretë e patën paraqitjen më të zbehtë, kur u kufizuan në 11 pikë.

Seti i katërt e gjeti në ritëm të mirë Kosovën që u bë pjesë e dramës, deri në 24:24.

Në fund Mali i Zi e fiton setin e katërt 26:24, për ta mbyllur ndeshjen 3:1.

FVK e përgëzon stafin dhe vajzat, për punën e përkushtimin, që ta japin më të mirën në këto kualifikime.




MBYLLET AFATI KALIMTAR I JANARIT, 29 KËRKESA

1 Shkurt, 2024

Komisioni për Kalime dhe Regjistrim pranë FVK-së, i ka pranuar 29 kërkesa në garat e djemve dhe vajzave, për ndërrim klubi, respektivisht mes tyre edhe ardhje të reja.

Dominojnë kërkesat e regjistruara përmes sistemit ndërkombëtar VIS, ku janë evidentuar 8 te djemtë dhe 15 te vajzat.

Kurse kërkesa për transfer vendor janë 6 (3 djemtë & 3 vajzat).



GJINOVCI E NIKÇI NË ASAMBLENË E BVA-së

2 Shkurt, 2024

Përfaqësuesit e Federatës së Volejbollit të Kosovës, Presidenti Bahri Gjinovci dhe Sekretari i Përgjithshëm Valon Nikqi, po marrin pjesë në Asamblenë e 25-të të Asociacionit Ballkanik të Volejbollit (BVA) që po mbahet në Sofje, Bullgari.

Delegacioni kosovar diskutoi çështje të rëndësishme dhe zhvillimet e volejbollit në rajon, shprehur në platformën e BVA për bashkëpunim dhe avancim të këtij sporti në Ballkan.

Krahas shumë diskutimeve, 10 presidentët e Federatave respektive nga vendet e Ballkanit, vendosën unanimisht që presidentit të FSHV-së Erlind Pëllumbi, t'i besohet pozita e presidentit të BVA-së.

Kjo është hera e dytë brenda 10 viteve që volejbollit shqiptar i besohet presidenca.

FVK e uron presidentin Erlind Pëllumbi, për detyrën që iu besua, duke i ofruar përkrahje të parezervë në secilin aspekt.



BAJRAMI E KRASNIQI SHPRESA OLIMPIKE

6 Shkurt, 2024

Erion Bajrami e Jona Krasniqi janë përzgjedhur në mesin e Shpresave Olimpike për vitin 2024, nga sporti i volejbollit.

Bajrami e Krasniqi janë zyrtarizuar pas përzgjedhjes që ka bërë Komisioni i Sportit pranë KOK-ut.

Dyshja nga sporti i volejbollit, është në mesin e 42 bursistëve që vijnë nga 19 sporte olimpike, e të cilët janë deri në moshën 21 vjeçare.

Sportistët do të mbështeten nga KOK-u me nga 150euro në muaj për gjatë gjithë vitit 2024.

Përzgjedhja e 40 të tillëve është bërë nga komisioni i sportit, pas nominimeve të dërguara nga federatat, ndërsa dy bursistë u shtuan me propozim të Bordit Ekzekutiv.

Gjatë vitit të kaluar, KOK kishte ndarë 25 bursa për sportistët e rinj.



ZV.MINISTRJA OSMANI VIZITË NË FVK - NËNSHKRUHET MEMORANDUMI

7 Shkurt, 2024

Pas mbylljes se procesit të kategorizimit, të mërkurën është bërë edhe lëvizja e rradhës, duke u nënshkruar memorandumi me MKRS-në.

Zv. Ministrja Daulina Osmani, ka qëndruar në Federatën e Volejbollit të Kosovës , ku është pritur nga presidenti i FVK-së Bahri Gjinovci.

Me këtë rast mes palëve është nënshkruar memorandumi, përmes së cilit do të përfitojë FVK, nga buxheti i subvencionimit të Federatave, që MKRS e ndan çdo vit.

Procesi i kategorizimit e rradhiti FVK-në në mesin e dy federatave të vetme të sporteve ekipore që janë në Kategorinë A.

Federata e Volejbollit e Kosovës tuboi nga ky proces 85,2 pikë, sipas së cilit në vitin 2024 do të ketë buxhet nga MKRS në vlerë prej 255,600€.

Vlera e pikës sivjet është përcaktuar në kuotën e 3,000€ për secilën Federatë.

Falë përkushtimit të komunitetit dhe rezultateve të arritura, FVK mbetet në kategorinë A, e kjo do të jetë motiv e detyrë për angazhim akoma më të madh në vitin 2024.



RAIFFEISEN SUPERLIGA A • NË FUNDJAVË FILLON SEZONI PRANVEROR

8 Shkurt, 2024

E shtuna dhe e diela e risjellin vëmendjen në elitat e volejbollit kosovar në të dyja konkurencat.

Gjatë fundjavës, fillon sezoni pranveror i Raiffeisen Superligës A, në konkurencën e djemve dhe vajzave, me ndeshjet e javës së 11-të.

Te djemtë, Raiffeisen Superliga A nis me dy ndeshjet e së shtunës.

Në derbin e javës, Drita takohet me Pejën, në ndeshjen që zhvillohet nga ora 17:00 dhe transmetohet drejtpërdrejt në RTK4.

Takimi tjetër i së shtunës e vë përballë Ulpianën e Ferizajn, nga ora 18:00.

Xhiroja e parë e pranverës në Raiffeisen Superliga A (djemtë), mbyllet me ndeshjen e së dielës mes Golden Eagle Therandës dhe Skenderbeut.

Në konkurencën e vajzave, ndeshja kryesore zhvillohet të dielën nga ora 17:00, mes Fushë Kosovës dhe Prishtina '75.

Kjo ndeshje, shkaku i transmetimit në RTK4, do të zhvillohet në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë.



AKTIVITET I VOLEJBOLLIT NË MALISHEVË

13 Shkurt, 2024

Me organizim të KVF Malisheva dhe mbështetjen e Komunës së Malishevës e të Federatës së Volejbollit të Kosovës, është mbajtur turneu për nder të 16 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës.

Në këté turne të vajzave, pjesëmarrëse ishin ekipet: KVF Malisheva, KV Vëllaznimi, KV Theranda dhe KV Llapi.

Në finale u kualifikuan KV Vëllaznimi e KV Theranda.

Skuadra gjakovare e fitoi këtë garë, në një ndeshje interesante në aktin final.

Për më të mirët u ndanë mirënjohje, kupa e medalje.

Turneu i Pavarësisë në volejboll, është garë tradicionale e organizuar nga KVF Malisheva.



TURNEU PAVARËSIA NË GJAKOVË

16 Shkurt, 2024

Në kuadër të aktiviteteve të organizuara në mbarë Kosovën, për nder të 16 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, një turne i volejbollit në konkurencën e vajzave është mbajtur edhe në Gjakovë.

Me organizim të KV Vëllaznimi dhe mbështetjen e Drejtorisë për Kulturë, Rini e Sport, si dhe të Federatës së Volejbollit të Kosovës, është mbajtur turneu njëditor i volejbollit.

Pjesëmarrëse në këtë garë ishin klubet: KV Vellaznimi nga Gjakova, KV Prishtina Elite nga Prishtina, KVF Malisheva nga Malisheva dhe KV Feronikeli nga Drenasi.

Rivaliteti mes skuadrave solli turne mjaft cilësor, ku KV Vellaznimi u shpall kampion.

Në gjysmëfinale u takuan KV Vellaznimi - KV Malisheva, takim që përfundoi 3:0 dhe KV Prishtina Elite - KV Feronikeli 2:3.

Në finalen u ballafaquan Vellaznimi - Feronikeli, në një ndeshje me shumë emocione, ku pas një loje të fortë Vellaznimi u shpall kampion duke fituar 3:0.



SUPERLIGA B, ORARI DHE NDESHJET

16 Shkurt, 2024

Superliga B në konkurencën e djemve dhe vajzave, këtë fundjavë i zhvillon ndeshjet përmes së cilave fillon gara e stinorit oranveror.

Në Superligën B te djemtë (lindje dhe perëndim) janë në program ndeshjet e xhiros së 6-të, kurse në Superligën B te vajzat do të zhvillohen ndeshjet e javës së 8-të.







LIGA E PARË • ORARET DHE NDESHJET

16 Shkurt, 2024

Gara në Ligën e Parë të vajzave në volejboll (lindje e perëndim), të shtunën e të dielën vazhdon rikthehet me ndeshjet e para të sezonit pranveror.

Me ndeshjet e kësaj jave, hapet perdja e pjesës së dytë të kampionatit, ku priten ndeshje interesante.





SHORTI • KUPA E KOSOVËS 2024

1 Mars, 2024

Marsi e sjell edhe garën e Kupës së Kosovës.

Duelet për trofeun më të çmuar të volejbollit kosovar, gjatë muajit Mars, pritet t'i sjellin emocion shtesë sportit të rrjetës.

Këto janë çiftet konkurencës së meshkujve.



SHORTI • KUPA E KOSOVËS 2024

1 Mars, 2024

Edhe në konkurencën e femrave, muaji Mars e sjell edhe garën e Kupës së Kosovës.

Konkurenca duket dukshëm më e lartë te kjo gjini, pasi numri i skuadrave të paraqitura është më i lartë se te meshkujt,

Duelet për trofeun më të çmuar të volejbollit kosovar, gjatë muajit Mars, pritet t'i sjellin emocion shtesë sportit të rrjetës.

Këto janë çiftet konkurencës së femrave.



LIGA GJERGJ KASTRIOTI- GJYSËMFINALET

2 Mars, 2024

Liga Gjergj Kastrioti • Gjysmëfinalet (djemtë)

E shtunë, 02.03.2024

15:00h • Tirana vs Ferizaj (RTK1)

18:00h • Partizani vs Peja (RTK1 & RTK4)



MBYLLET LIGA GJERGJ KASTRIOTI, NDEROHET PRESIDENTI GJINOVCI

4 Mars, 2024

Presidenti i FVK-së Bahri Gjinovci, është nderuar nga Federata Shqiptare e Volejbollit, në një ceremoni të veçantë, pak para fillimit të finales së vajzave në Ligën Gjergj Kastrioti.

Gjinovci e ka pranuar fanelën e personalizuar të Kombëtares së Shqipërisë me numrin 6, nga homologu i tij nga Shqipëria Erlind Pëllumbi.

Poashtu zv. Presidenti i FSHV-së Dashamir Brari, i ka dhuruar edhe pinin e veçantë me potretin e heroit kombëtar Gjergj Kastrioti.

Edicioni i tretë i Ligës Gjergj Kastrioti, solli një garë interesante, ku në fazën finale ishin 3 skipet nga Kosova: Drita (F) dhe Peja e Ferizaj (M).

FVK e falënderon FSHV-në për organizimin shembullor të kësaj gare, si dhe qytetin e qytetarët e Korçës, që për tre ditë rradhazi sollën spektakël në tribina e kudo.

Shtëpia kosovare e volejbollit i uron ekipet kampione Partizani (M) dhe Skënderbeu (F), duke u dëshiruar mbarësi edhe në garat tjera.

U mbyll një edicion fantastik me një format të përshtatshëm dhe që u tregua i suksesshëm edhe në praktikë.





ILAZI E HAXHIKADRIJA PJESË E KAMPIT NË ITALI

6 Mars, 2024

Dy trajnerët kosovarë Lorik Ilazi e Blendi Haxhikadrija, janë pjesë e grumbullimit së bashku me trajnerët italianë, i cili ka filluar të mërkurën e do të vazhdojë për 5 ditë rradhazi.

Ilazi dhe Haxhikadrija po ndjekin nga afër metodat më të reja, të cilat aplikohen në volejbollin modern nga strategët italianë, në qendrën zhvillimore të CEV "Centro Pavesi" afër Milanos në Itali.

Nga viti 2023 Federata e Volejbollit e Kosovës (FVK) e ka nisur me bashkëpunimin konkret me Federatën Italiane të Volejbollit (FIPAV), përmes së cilit do të ketë shkëmbim të trajnerëve, duke u ofruar mundësi ideale kuadrove nga Kosova që të prekin nga afër trendin e zhvillimit të volejbollit, në një prej vendeve që njihet si superfuqi e këtij sporti.

Më herët trajnerët italianë kanë qenë në Kosovë, gjithashtu për të ndarë njohuritë me kolegët e tyre kosovarë, kurse Ilazi e Haxhikadrija, janë pjesë e grupit të parë të trajnerëve nga Kosova, që përfitojnë nga mundësia për të parë nga afër praktikat moderne të trajnimit në volejbollin evropian.

Projekti do të vazhdojë mes FVK-së dhe FIPAV-it edhe me shkëmbime të njëjta për menaxherët e ekipeve Kombëtare si dhe stafit tjetër, në përpjekje për ngritur kapacitetet kadrovike të volejbollit kosovar.

FVK e falënderon Federatën Italiane të Volejbollit (FIPAV), për bashkëpunimin dhe gadishmërinë për ta mbështetur sportin e rrjetës në vendin tonë.



FVK I FITON 3 PROJEKTE TË REJA NGA FIVB

13 Mars, 2024

Federata e Volejbollit e Kosovës ka arritur t'i sigurojë edhe tri projekte të mëdha nga Federata Botërore e Volejbollit (FIVB).

Pas aplikimit të suksesshëm, FIVB i ka aprovuar dhe e ka njoftuar FVK-në se është fituese e tri projekteve që lidhen me "Volleyball Empoëerment" (Fuqizimi i volejbollit).

Projektet kanë të bëjnë me:

- Programin për zhvillim të trajnerëve të ekipeve Kombëtare

- Programin për zhvillim të referëve

- Programin për zhvillim të menaxherëve dhe stafit administrativ.

"Volleyball Empoëerment" është program me të cilin identifikohet FIVB, falë iniciativës së presidentit të saj Dr. Ary Graça, që të mbështesë ekipet kombëtare në 5 nivele të ndryshme.

Implementimi i projekteve të para do të fillojë në shtator 2024 dhe do të vazhdojë deri në përmbylljen e tyre.

SHORT I VËSHTIRË NË KUALIFIKIMET E CEV EUROVOLLEY

13 Mars, 2024

Kombëtarja e Kosovës në volejboll, te djemtë e vajzat, i ka mësuar kundërshtarët për kualifikimet e CEV EuroVolley 2026.

Në të dyja gjinitë, Kosovën e presin sfida serioze.

Te meshkujt, Kosova është në grup me Sllovakinë e Letoninë.

Ndeshjen e parë "Dardanet" e zhvillojnë para publikut vendas, më 17/18 gusht 2024, përballë Letonisë.

Te femrat, Kosova është në grup me Rumaninë e Kroacinë, poashtu dy rivalë shumë cilësorë.

Volejbollistet tona e hapin kampanjën e kualifikimeve në ndeshjen me Kroacinë, të cilën e luajnë si vendase, më 17/18 gusht 2024.

FVK u uron shumë suksese ekipeve tona Kombëtare, duke kontribuar direkt në mbështetjen e grumbullimeve dhe çdo formë tjetër, që ekipet tona ta kenë paraqitjen sa më dinjitoze.





FVK E FITON TË DREJTËN E ORGANIZIMIT TË KURSIT TË TRAJNERËVE - NIVELI 2

14 Mars, 2024

Federata e Volejbollit e Kosovës e ka marrë edhe një lajm tjetër të mirë nga Federata Ndërkombëtare e Volejbollit (FIVB).

Pas lajmit të mirë për fitimin e tri projekteve për ekipet kombëtare dhe trajnerët në kuadër të projektir "Volleyball empoëerment", FVK e ka siguruar edhe të drejtën për organizimin e nivelit të dytë të kursit për trajnerët e volejbollit.

Dy vjet më parë FVK e kishte fituar të drejtën për organizimin e Nivelit 1, kurse vitin e kaluar në formë online ishte organizuar ehe Niveli 2 i kurseve.

Sivjet do të jetë hera e parë që FVK do ta ketë mundësinë që edhe në aspektin teknik, përmes prezencës fizike ta organizojë këtë kurs, i cili shihet si rast i mirë për trajnerët e volejbollit, që të ngriten profesionalisht dhe të marrin thirrje të çertifikuara ndërkmbëtare.

Kursi i Nivelit 2 për trajnerët e volejbollit, do të mbahet nga 1 deri më 5 korrik 2024, kurse lokacioni dhe detajet tjera pritet të bëhen publike javëve në vijim.

Marrjen e kësaj të drejte FIVB e ka konfirmuar edhe në faqen e vet zyrtare, përmes njoftimit të publikuar për të gjitha shtetet që kishin aplikuar për kurse të ngjajshme, në nivele të ndryshme.



KV VËLLAZNIMI KAMPION I LIGËS SË PARË (F) PERËNDIM

24 Mars, 2024

Të shtunën, KV Vëllaznimi është kurorëzuar me titullin kampion në Ligën e Parë (F) - perëndim, pas një viti të suksesshëm, që e mbyll me promovim në një rang më lartë.


Në xhiron e 13-të, KV Vëllaznimi e zhvilloi ndeshjen e fundit, ndaj KV Peja, ku arriti fitore prej 3-1, duke e mbyllur edicionin me rekord 100%, nga 13 fitore në 13 ndeshje.

Skuadra e drejtuar nga Blendi Haxhikadrija nga sezoni j ardhshëm promovohet në Raiffeisen Superligën B.

Medaljet për ekipin kampion i ndanë z.Valon Nikqi, sekretar i përgjithshëm i FVK-së dhe z.Labinot Efendija, udhëheqës i sektorit për sport në Gjakovë.

Kupa u dorëzua nga presidenti i FVK-së z.Bahri Gjinovci dhe u.d. Drejtori për Sport në Gjakovë z. Xhavit Alijaj.

FVK e përgëzon KV Vëllaznimin dhe qytetin e Gjakovës, për angazhimin në promovimin e volejbollit, duke u uruar shumë suksese edhe në garat e sfidat e ardhshme.





PRISHTINA KAMPION I SUPERLIGËS B (DJEMTË)

24 Mars, 2024

KV Prishtina është rikthyer në Raiffeisen Superligën A te djemtë, pasi në finalet e barazhit shënoi fitore prej 3:0 ndaj Lubotenit.

Skuadra prishtinase shënoi fitore duke triumfuar në tre setet me shifrat 24:14; 25:23; 25:23.

Medaljet ekipit kampion ia ndau drejtori për sport në Komunën e Prishtinës z. Bardh Krasniqi, kurse në ndarjen e trofeut, z. Krasniqi iu bashkua edhe presidenti i FVK-së z. Bahri Gjinovci.

Në Raiffeisen Superligën A, është inkuadruar edhe Luboteni, e cila skuadër pavarësisht se nuk e siguroi trofeun e Superligës B, pati konsistencë në lojë, duke u rikthyer në elitë.

Në ndeshjen tjetër të barazhit, KV Vëllaznimi e mposhti 3:0 KV AS Vushtrinë.

Tash KV Vëllaznimi takohet me skuadrën që përfundon e fundit në Superligën A, kurse KV AS Vushtrria e kërkon rikthimin në Raiffeisen Superligën A, duke u ndeshur me ekipin që rangohet i 5-ti (parafundit) në elitë.





MBAHET KUVENDI I PUNËS I FVK-së

25 Mars, 2024

Federata e Volejbollit e Kosovës (FVK), e ka mbajtur kuvendin e rregullt të punës 2023.

Kuvendi i mbajtur në Holiday Resort në Sllatinë të madhe kaloi me votim unanim të pikave të rendit të ditës. Nga 38 delegatë të pranishëm në Kuvendin e Punës, të gjithë unanimisht i aprovuan pikat e rendit të ditës, duke i dhënë dritën e gjelbërt proceseve të mbyllura dhe atyre që janë para në kalendarin e ngjarjeve të FVK-së.

Në këtë Kuvend të Punës është paraqitur edhe raporti i punës dhe aktiviteteve të ngjeshura të FVK-së për vitin 2023, përmes së cilave është lënë gjurmë e re në komunitetin e volejbollit në vendin tonë.

Poashtu gjatë vitit 2024, FVK ka paraqitur planin e aktiviteteve të shumta, edhe të garave ndërkombëtare, përfshirë rikthimin e aktivitetit të Kombëtareve A të djemtë dhe vajzat si dhe atë financiar për vitin 2024.

Gjatë këtij viti pritet që të rritet dukshëm edhe aktiviteti i garave ndërkombëtare të Kombëtares sonë në të gjitha grupmoshat, si dhe garave tjera vendore e ndërkombëtare në të gjitha nivelet.

I pari i FVK-së z. Bahri Gjinovci, i ftoi edhe delegatët e pranishëm për diskutime në secilën prej pikave që ata kanë patur interes, dhe të gjitha pikat kaluan me unanimitet, pa asnjë votë kundër.

Ndër arritjet më të mëdha të volejbollit është, suksesi Kombëtares U17 femrat në volejboll, suksesi i ekipeve Kombëtare të beach volley-it, promovimi medial, rritja e kapaciteteve të trajnerëve të Kombëtareve.

Poashtu u theksua qartë edhe arritja e sponsorizimit me shumë partnerë, mes tyre edhe me Raiffesen Bankën si dhe marrëveshja e bashkëpunimit me Federatën Italiane (FIPAV), si strategji afatgjate në shërbim të rritjes së volejbollit në vendin tone dhe si dhe implementimi i sistemit elektronik e-scoresheet.





KV TREPÇA KAMPION I LIGËS 1 (LINDJE)

29 Mars, 2024

KV Trepça e ka mbyllur një sezonë fantastike në Ligën e Parë (lindje), pasi në ndeshjen e fundit të edicionit 2023/24 e mposhti AS Vushtrrinë 3:0 (25:15; 25:18; 25:12).

"Xehetaret" e mbyllën sezonin me 38 pikë, me 13 fitore nga 14 ndeshje, duke arritur promovimin në Raiffeisen Superligën B.

Kupën kampioneve ua ndau presidenti i FVK-së Bahri Gjinovci, kurse nënkryetari i Mitrovicës Arian Tahiri i ndau medaljet e arta.

FVK e përgëzon KV Trepça dhe qytetin e Mitrovicës për suksesin e arritur, duke uruar që ky promovim do t'i motivojë të gjithë për mbështetje akoma më të madhe e rezultate tjera kulmore.





KOMBËTARJA U20 (VAJZAT) PËRGATITET PËR CEV EUROVOLLEY

30 Mars, 2024

Nga 28 mars 2024, Kombëtarja U20 (F) ka filluar përgatitjet në prag të ndeshjeve që e presin në raundin e dytë kualifikues të CEV EuroVolley.

"Dardanet" e drejtuara nga strategu turk Ali Bahadur Aksoy, po zhvillojnë grumbullimin në Skenderaj.

Trajneri turk, i asistuar nga dy trajjerét kosovarë Ylli Kadriu e Dardan Husaj, do të mundohen të punojnë në komponimin sa më të mirë të Kombëtares.

Kosova ndeshjet kualifikuese të grupit i zhvillon në Sllovaki, ku krahas nikoqirit, bën gara edhe me Greqinë e Spanjën.

Ndeshjet zhvillohen nga 5-7 prill 2024.

FVK i uron shumë sukses stafit dhe vajzave në sfidat e tyre kualifikuese për CEV U20 EuroVolley.



KUPA E KOSOVËS • REZULTATET E GJYSMËFINALEVE

30 Mars, 2024

Pas gjysmëfinaleve të zhvilluara të shtunën, janë përcaktuar edhe finalistët e të dyja konkurencave në Kupën e Kosovës për vitin 2024.



KV PEJA E FITON KUPËN E KOSOVËS

31 Mars, 2024

Volejbollistët e skuadrës “verdhezi” e mposhtën në finale KV Ferizajn me rezultat 3:1.



KV DRITA E FITON KUPËN E KOSOVËS 2024

31 Mars, 2024

Drita e fitoi trofeun e tetë të Kupës së Kosovës në volejboll, pasi në finale e mposhti Fushë Kosovën me rezultat 3:0.



KV FERIZAJ PROMOVOHET NË RAIFFEISEN SUPERLIGËN A

1 Prill, 2024

Pas fitores së javës së fundit ndaj KV Prishtina, klubi ferizajas KV Ferizaj e ka siguruar promovimin në Raiffeisen Superligën A.

Kupën për KV Ferizaj e ndau presidenti i FVK-së Bahri Gjinovci, së bashku me drejtoreshën për sport në Ferizaj, Xhemile Murati-Shabani.

FVK e përgëzon KV Ferizaj për inkuadrimin në elitë, që përkon me 10 vjetorin e themelimit të klubit.



KOSOVA U20 E ZHVILLON STËRVITJEN E PARË NË SLLOVAKI

4 Prill, 2024

Kombëtarja e Kosovës në volejboll, e ka zhvilluar stërvitjen e parë pas arritjes në Sllovaki, ku do t'i zhvillojë garat e turneut kualifikues për CEV U20 EuroVolley.

Volejbollistet tona të drejtuara nga Ali Bahadir Aksoy, me të arritur në Sllovaki, e kanë zhvilluar stërvitjen e parë, në të cilën është konfirmuar atmosfera e mirë brenda grupit tonë.

FVK e ka mundësuar grumbullimin disa ditor të Kombëtares U20, e u uron suksese në kampanjën e kualifikimeve.



KOMBËTARJA U18 NË PËRGATITJE INTENZIVE PARA KUALIFIKIMEVE

7 Prill, 2024

Në prag të kualifikimeve të grupmoshës U18, në CEV EuroVolley, Kombëtarja U18 e vajzave po zhvillon përgatitjet intenzive, për sfidat që i presin.

Përzgjedhësi Berat Husaj dhe ndihmësit e tij Drilon Haziri e Elmi Zymeri, nga data 3 prill janë duke e zhvilluar grumbullimin në Skenderaj.

Kosova kualifikimet për CEV U18 EuroVolley, i zhvillon në Itali, ku krahas nikoqirit nga "Apeninet", në grup me Kosovën janë edhe dy Kombëtare shumë cilësore, Hungaria e Sllovakia.

FVK u uron shumë suksese volejbollisteve tona të Kombëtares U18.





KOSOVA U20 I MBYLLI KUALIFIKIMET PËR CEV EUROVOLLEY

7 Prill, 2024

Volejbollistet e Kombëtares U20, kanë pësuar edhe në ndeshjen e tretë të kualifikimeve për CEV Kampionatin Evropian të kësaj grupmoshe.

Në një grup tejet konkurues e të vështirë, Kosova e ka mbyllur aventurën në këto kualifikime me tri humbje, nga Sllovakia, Spanja, e të dielën edhe nga Greqia.

Në duelin me Greqinë, Kosova në setin e parë u kufizua në 16 pikë, para se në setin e dytë ky kufizim të ulej në 10 pikë.

Periudha e dytë, ishte edhe më e zbehta në këtë paraqitje.

Në setin e tretë, Greqia vazhdoi me të njëjtin ritëm dhe e siguroi fitoren e dytë në grup, pasi më herët e kishte mposhtur edhe Sllovakinë, 3 me 2.

Paraqitja në këto kualifikime, pa dyshim është përvojë e re për vajzat e kësaj grupmoshe, duke dhënë sinjale për përmirësim edhe në rrafshin e konkurencës ndërkombëtare.



RAIFFEISEN SUPERLIGA A (DJEMTË)

7 Prill, 2024

Tabela - Java 20

Rënditja finale e pjesës së rregullt të garave në Raiffeisen Superligën A (djemtë), pas së cilës, gjysmëfinalet e Play-OFF do të jenë si më poshtë:

KV PEJA vs KV DRITA

KV SKËNDERBEU vs KV FERIZAJ



KOSOVA U18 GATI PËR KUALIFIKIMET E CEV EUROVOLLEY

8 Prill, 2024

Kualifikimet e raundit të dytë të CEV U18 EuroVolley, për grupin e Kosovës, do të zhvillohen nga 11-13 prill 2024, në Gjakovë.

Në palestrën "Shani Nushi" po zhvillohen përgatitjet e djemve të Kombëtares, të cilët janë grumbulluar nga 3 prilli.

Nën drejtimin e përzgjedhësit Blendi Haxhikadrija dhe ndihmësve të tij Valon Mustafa e Fatlum Hajrizi, "Dardanét" po bëhen gati për sfidat në një grup aspak të lehtë.

Kosova do t'i presë në Gjakovë, kombëtaret e Danimarkës, Çekisë e Estonisë.

Sfida e parë e “Dardanëve” është më 11 prill ndaj Danimarkës, nga ora 19:30.

FVK u uron shumë suksese djemve dhe shtabit teknik, në misionin e tyre drejt këtyre kualifikimeve.





GJAKOVA I PRET KUALIFIKIMET E CEV EUROVOLLEY

9 Prill, 2024

Për tre ditë rradhazi, në Gjakovë do të zhvillohen ndeshjet e kualifikimeve të CEV EuroVolley U18 në konkurencën e djemve.

Kombëtarja U18 e djemve ka nevojë për mbështetjen tuaj, në duelet me Danimarkën , Çekinë e Estoninë

Ju presim në Pallatin e Sporteve “Shani Nushi” në Gjakovë.



KOMBËTARJA U18 ARRIN NË ITALI, TË PREMTEN NISIN KUALIFIKIMET

11 Prill, 2024

Kombëtarja U18 te vajzat ka arritur në Itali, ku do t'i zhvillojë ndeshjet e turneut kualifikues për CEV U18 Kampionatin Evropian në volejboll.

Përzgjedhësi Berat Husaj dhe ndihmësit e tij Drilon Haziri e Elmi Zymeri, nga data 3 prill kanë zhvilluar përgatitje intenzive përmes grumbullimit të realizuar në Skenderaj.

Me të arritur në Cavalesse të Italisë, Kombëtarja e ka zhvilluar edhe stërvitjen e parë atje, me qëllim të akomodimit me kushtet e palestrës që i pret ndeshjet.

Kosova kualifikimet për CEV U18 EuroVolley, i zhvillon në Itali, ku krahas nikoqirit nga "Apeninet", në grup me Kosovën janë edhe dy Kombëtare shumë cilësore, Hungaria e Sllovakia.

"Dardanet" do të kenë këtë orar të ndeshjeve:

12.04.2024, 19:00h • Italia vs Kosova

13.04.2024, 16:00h • Hungaria vs Kosova

14.04.2024, 16:00h • Kosova vs Sllovakia

FVK u uron shumë suksese volejbollisteve tona të Kombëtares U18.



RAIFFEISEN SUPERLIGA A (VAJZAT)

11 Prill, 2024

Rënditja e pjesës së rregullt të garave në Raiffeisen Superligën A (vajzat).

Pas ndeshjes Skënderaj 2-3 Fushë Kosova, u mësua edhe rangimi final në pjesën e rregullt të garave, pas 20 xhirove të zhvilluara.

Gjysmëfinalet tashmë janë përcaktuar në garat e play-off dhe ato janë:

Drita - Prishtina 75

Fushë Kosova - Skenderaj

Në gjysmëfinale luhet me dy ndeshje të fituara, kurse në finale, kampioni përcaktohet në tri ndeshje të fituara.



KV PEJA NË FINALE TË PLAY OFF-it

21 Prill, 2024

Klubi i volejbollit Peja ka arritur të siguroj finalen e play off-it pas fitores në ndeshjen e tretë gjysmëfinale kundër Dritës.

Pas humbjes në ndeshjen e dytë, Peja ka arritur të shënoj fitore të pastër 3:0 në sete.

Seti i parë dhe i tretë ishin më bindës për Pejen, ndërsa në setin e dytë Drita ishte në avantazh dhe kishte mundësi të fitonte setin, mirëpo nuk e shfrytëzuan këtë mundësi.

Peja në finale do të takohet me Skenderbeun i cili ka siguruar finalen në dy përballjet e para me Ferizajn.



PRISHTINA ELITE PROMOVOHET NË SUPERLIGËN B

21 Prill, 2024

Skuadra nga kryeqyteti ka arritur që të promovohet në Superligën B, pasi një viti të suksesshëm në Ligën e Parë.

Në ndeshjen e barazhit, Prishtina Elite fitoi 3-2 ndaj Malishevës, për ta siguruar plasmanin në nivelin e dytë elit të garave.

FVK e përgëzon Prishtina Elite për suksesin e arritur.



KV GJINOCI RIKTHEHET NË RAIFFEISEN SUPERLIGËN A

21 Prill, 2024

KV Gjinoci ka arritur që të rikthehet pas një periudhe të gjatë në Raiffeisen Superligën A.

Skuadra nga regjioni i Suharekës, arriti që në turneun e ndeshjeve të barazhit në Gjilan, ta mposhtë KV Kastriotin, e cila skuadër e humb statusin e anëtarit të elitës.

Gjinoci fitoi 3-0 në duelin e vlefshëm për ta siguruar garumin në Raiffeisen Superligën A, duke e mbyllur në formën më të mirë këtë edicion, mjaft konkurues.

FVK e përgëzon KV Gjinoci për suksesin e arritur!



GOLDEN EAGLE THERANDA MBETET NË RAIFFEISEN SUPERLIGËN A

21 Prill, 2024

Volejbollistët e Golden Eagle Therandës e kanë kaluar testin më të rëndësishëm të edicionit, kur në ndeshjen e play-out në barazh, fituan ndaj KV AS Vushtrria me rezulrat 3-0.

Triumfi i mundëson therandasve të mbeten në rangun elit të volejbollit të djemve, në Raiffeisen Superligën A.

FVK e përgëzon GE Theranda, kurse AS Vushtrrisë i uron poashtu sukses, duke e inkurajuar për punë dhe angazhim që këtë synim ta realizojë edicioneve të ardhshme.



KV ULPIANA MBETET NË RAIFFEISEN SUPERLIGËN A

21 Prill, 2024

Klubi lipjanas KV Ulpiana në konkurencën e djemve, ka arritur që ta ruajë statusin e anëtarit të Raiffeisen Superligës A, pasi në ndeshjen e fundit të turneut njëditor të barazhit, të mbajtur në Gjilan, shënoi fitore ndaj KV Vëllaznimi.

Skuadra e Superligës B, KV Vëllaznimi nuk arriti të bëjë më shumë, për ta rrezikuar triumfin e Ulpianës, pasi u gjunjëzua 3:1.

FVK e përgëzon KV Ulpiana, derisa skuadrës gjakovare i uron të vazhdojë me përkushtimin dhe punën e mirë.



PEJA - SKËNDERBEU, FINALJA E PARË

23 Prill, 2024

Të enjten fillon seria e finaleve të Play-OFF, në Raiffeisen Superligën A, në konkurencën e djemve.

Peja e Skënderbeu, janë dy ekipet finaliste, që e vazhdojnë "odisejadën" e tyre për titullin e kampionit.

Dy skuadrat që edhe gjatë pjesës së rregullt të kampionatit i prinin rënditjes, me Pejën lider, e Skënderbeun si ndjekësin e parë.

Ndeshja zhvillohet të enjten në orën 20:00 në Pallatin e Sporteve "Karragaçi" dhe transmetohet drejtpërdrejt në RTK4.



DRITA E SKËNDERAJ, SERIA E FINALEVE NGA E DIELA

24 Prill, 2024

Të dielën do të zhvillohet ndeshja e parë e serisë së finaleve në garën për totullin e kampionit në Raiffeisen Superligën A, në konkurencën e vajzave.

Edhe sivjet, sikurse vitin e kaluar, protagoniste janë skuadrat e njëjta, Drita e Skenderaj.

Dy klubet rivale, që edicionin e kaluar dhuruan spektakël prej 5 finaleve fantastike, e fillojnë aventurën e sivjeme të finaleve nga e diela.

Në Pallatin e Sporteve "Bashkim Selishta-Petriti" në Gjilan, të dielën nga ora 20:00 zhvillohet ndeshja e parë, pasi gjilanaset e kanë përparësinë e terenit vendas.

Ndeshja do të transmetohet drejtpërdrejt në faqen zyrtare të FVK-së dhe kanalin tonë zyrtar në YouTube.



PEJA E FITON FINALEN E PARË

25 Prill, 2024

KV Peja e ka fituar takimin e parë të serisë së finaleve të Play-OFF në Raiffeisen Superligën A të volejbollit, pasi e mposhti Skënderbeun 3 me 0.

Ndeshja nisi mirë për skuadrën mysafire e cila avansoi 12:8 në setin e parë, por "verdhezinjtë" arritën të rikthehen duke e fituar periudhën e parë 25:20.

Seti i dytë ishte më bindës për kampionin në fuqi, pasi e kufizoi Skënderbeun në 16 pikë.

Rivaliteti më i madh u pa në setin e tretë, gjatë së cilit plot 8 herë u barazua rezultati, duke sjellë dramë deri në fund të tij.

Peja fiton edhe në këtë periudhë 25:22, pavarësisht se kjo ishte paraqitja më e mirë e Skënderbeut, gjatë kësaj ndeshje.

Peja me këtë fitore, e bën hapin e parë drejt mbrotjes së titullit të kampionit, në serinë e finaleve ku luhet me 3 ndeshje të fituara.



PLAY-OFF I GRUPMOSHËS U18

26 Prill, 2024

Ferizaj e Lipjani, do të jenë vendtakim i ekipeve që e kanë siguruar garimin në Play-OFF të grupmoshës U18.

Në konkurencën e djemve çerekfinalet e garave shtesë zhvillohen në palestrën “Better Life” në Lipjan, kurse vajzat do t’i zhvillojnë garat në Pallatin e Sporteve “Bill Klinton” në Ferizaj.





DY KLUBE TË REJA NË SKENËN E VOLEJBOLLIT

26 Prill, 2024

Federata e Volejbollit e Kosovës është e lumtur ta ndajë lajmin për rritjen e komunitetit të volejbollit, nga dita në ditë.

Ngritja e standardit në nivelin e garave elite, atë të Kombëtareve, organizativ dhe formave tjera, po përcillet me dëshirën e të rinjëve dhe të rejave që t'i bashkohen sportit të rrjetës.

Kësisoj, së fundi janë formuar edhe dy klube të reja të volejbollit, në qendrat ku mungonte aktiviteti i këtij sporti në këtë formë.

KV Prizreni dhe KV Alpha nga Isniqi i Deçanit, janë dy klubet e reja, që i shtohen skenës së volejbollit në vendin tonë.

FVK i përgëzon iniciatorët për themelimin e këtyre dy klubeve, duke u uruar ahumë suksese në misionin e tyre.

Klubet e reja, kanë treguar edhe në të kaluarën se mund t'ia dalin në një periudhë të shkurtër, të lënë gjurmët e para në garat elite të Kosovës, andaj urojmë që të njëjtin shembull e fat ta kenë edhe KV Prizreni e KV Alpha.



SUPER SUKSES I ADRIATIK KAJTAZIT

27 Prill, 2024

Trajneri 37 vjeçar kosovar Adriatik Kajtazi, ka arritur super sukses me skuadrën e tij zvicrane Schonenëerd, me të cilën u shpall kampion.

Në edicionin e parë në të cilin atij iu besua udhëheqja e skuadrës si kryetrajner, “Tiki” e ka arsyetuar besimin e klubit duke e shpallur Schonenëerdin, kampion të Zvicrës.

Rruga deri këtu nuk ishte aspak e lehtë, sepse u desh të luhej një seri maratonike prej 5 finaleve, derisa Kajtazi dhe skuadra e tij Schonenëerd, festuan në takimin e fundit 3-1.

Federata e Volejbollit e Kosovës (FVK), përmes presidentit Bahri Gjinovci dhe bordit, e uron Adriatik Kajtazin për suksesin e arritur në volejbollin zvicran.

Kujtojmë që Adriatik Kajtazi, gjatë karrierës së tij në volejboll, ka shijuar trofe të shumtë në aventurën në volejbollin e Kosovës, Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut e deri ne Katar.



BURIM ZYMERI GJYQTAR ME THIRRJE NDËRKOMBËTARE

1 Maj, 2024

Gjyqtari kosovar i volejbollit Burim Zymeri, e ka fituar thirrjen e gjyqtarit ndërkombëtar, në kursin për gjyqtar ndërkombëtar të mbajtur në Sofje të Bullgarisë.

Zymeri ishte në mesin e 23 kandidatëve që hynë në rrethin e ngushtë të vlerësimit dhe e ka kaluar me sukses këtë test, duke e fituar thirrjen e gjyqtarit ndërkombëtar.

Pas Istref Elezajt, tashmë volejbolli kosovar e ka edhe gjyqtarin e dytë ndërkombëtar, duke bërë një tjetër hap drejt rritjes së standardit të volejbollit në vendin tonë.

Federata e Volejbollit e Kosovës (FVK) e përgëzon gjyqtarin Burim Zymeri, duke u siguruar që ky numër i kuadrove tona në arenën ndërkombëtare, do té shtohet nga viti në vit.



PEJA TRIUMFON NË LIPJAN, AVANSON 2-0 NË FINALE

2 Maj, 2024

Kampioni i Kosovës në volejbollin e meshkujve, KV Peja, nuk ka lejuar befasi as në ndeshjen e dytë, kur u gostit në Lipjan nga Skënderbeu.

Verdhezinjtë fituan 3:1, në një ndeshje rivalizuese dhe me shumë dramë.

Peja e fitoi periudhën e parë 25:23, por që ky avantazh u neutralizua në setin vijues, pasi Skënderbeu festoi me të njëjtat shifra.

Peja u rikthye, kur pati përqëndrim më të madh në momentet përcaktuese për fituesin, në setin e tretë, kur triumfoi 28:26.

Edhe seti i katërt u përshkrua nga dramë e madhe, me Pejën që në fund e siguroi fitoren 25:22.



GARAT U16

3 Maj, 2024

Ekipet e grupmoshave U16, do të jenë në aksion gjatë të shtunës, me garat që do të zhvillohen në 5 grupe, varësisht nga regjionet.

Aktiviteti sjell një masovitet tjetër të ekipeve që janë pjesë e tij, në garën që pritet të nxjerrë kampionët e kësaj grupmoshe.



SKENDERAJ E FITON FINALEN E TRETË

5 Maj, 2024

KV Skenderaj ka shënuar fitore të rëndësishme në ndeshjen e tretë të serisë së finaleve në play-off të Raiffeisen Superligën A të volejbollit. Pas dy dramave dhe spektaklit të volejbollit, të dielën u zhvillua akti i tretë i serisë së finaleve në Play-OFF të Raiffeisen Superligës A, te femrat.

Dy duelet paraprake, skuadra nga Skenderaj ka qenë shumë afër fitores, sepse në të dyja ishte në avantazh (2:1, 2:0) para se të pësonte në të dyja rastet 3:2. Volejbollistet e drejtuara nga Ylli Kadriu, duket se kishin marrë leksione nga dy takimet paraprake, të cilat i lëshuan nga duart, duke reflektuar në takimin e tretë.

Drita e filloi shumë mirë ndeshjen, duke avansuar në dy setat e parë, mirëpo volejbollistet e drejtuara nga Ylli Kadriu, u mobilizuan duke e rikthyer ndeshjen, falë fitores në setet vijuese. Pas barazimit në 2 me 2, ishte prapë seti i pestë, që për të tretën finale rradhazi, e përcaktoi fituesin. Në një spektakël të volejbollit, para rreth 2500 spektaktorëve në "Bashkim Selishta-Petriti" në Gjilan, të dyja ekipet kanë dhuruar një shfaqje të mirë për të pranishmit. Seti i pestë u mbyll 15:10 në favor të Skenderajt, e cila skuadër e fitoi duelin e parë të serisë së finaleve, duke e ngushtuar rezultatin pas 3 finaleve të para, në 2-1 në favor të Dritës. Takimi i rradhës, i katërti i kësaj serie, zhvillohet në palestrën "Ilaz Kodra" në Skenderaj.

Takimi u përcoll nga afër nga zv. Ministrja e Sportit Daulina Osmani, kryetari i Gjilanit Alban Hyseni, drejtorët për sport të Gjilanit e Skenderajt, Kushtrim Zeqiri e Alban Berisha, presidenti i FVK-së Bahri Gjinovci, sekretari i përgjithshëm Valon Nikqi, nënkryetarja Mimoza Shkodra Bislimi, si dhe personalitete tjera.

Ndeshja e tretë finale u transmetua drejtpërdrejt në RTK1.



GE THERANDA KAMPION I U18

6 Maj, 2024

Volejbollistët e klubit Golden Eagle Theranda, janë shpallur kampionë të garës së grupmoshës U18.

GE Theranda në finalen e madhe e mposhti KV Skënderbeun 3-0 në sete, 25:17; 25:11 dhe 25:14.

Garat finale të të dyja grupmoshave, u zhvilluan në palestrën e Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit (FEFS).

Trofeun e kampionit e dorëzoi presidenti i FVK-së, medaljet e arta u ndanë nga sekretari i përgjithshëm Valon Nikqi, si dhe ish-kryetari i FVK-së m, Xhavit Mustafa, kurse të argjendtat nga Ilir Dedushi, anëtar i kryesisë së KV Skënderbeu.

FVK e përgëzon KV Golden Eagle Theranda për suksesin e arritura.





VAJZAT E SUTI SPORT KAMPIONE U18

6 Maj, 2024

KV Suti Sport nga Peja, ka arritur të kurorëzohet me titullin e kampionit, në konkurencën e femrave në grupmoshën U18. Volejbollistet pejane shënuan fitore prej 3-0 në finale ndaj KV Gjinoci.

Rezultati ishte i ngushtë në sete dhe ndeshja kaloi me rivalitet të madh në secilin prej tri periudhave të luajtura, ku Suti Sport triumfoi 25:22; 25:20; 25:21.

Kupën e Kampionit, fitueseve ua dorëzoi presidenti i FVK-së Bahri Gjinovci, kurse medaljet u ndanë nga sekretari i përgjithshëm i FVK-së Valon Nikqi.

FVK e përgëzon KV Suti Sport për suksesin e arritur në këtë grupmoshë.







PEJA E FITON TITULLIN E SHTATË

6 Maj, 2024

Peja i ka dhënë fund serisë së finaleve në Raiffeisen Superligën A, duke e fituar edhe ndeshjen e tretë.

Para rreth 1000 spektatorëve në "Karragaçi" të Pejës, skuadra verdhezi shënoi fitore prej 3:0 (30:28; 25:22; 25:21), duke e dominuar takimin me Skënderbeun.

Pavarësisht rivalitetit të madh në setin e parë, në të cilin u shënuan 58 pikë, Peja tregoi vendosshmëri që ta mbyllte dramën e titullit, qysh në ndeshjen e tretë.

Vendasit përkundër luhatjeve në rezultat, arritën që ta ruanin fokusin, drejt qëllimit të tyre,

Skuadrës finaliste, KV Skënderbeu, medaljet e argjendta u ndanë nga sekretari i përgjithshëm i FVK-së Valon Nikqi dhe anëtari i bordit Abedin Mehani.

Medaljet e arta për KV Peja, u dorëzuan nga nënkryetari i Pejës Fatmir Asllani dhe kryesuesi i Kuvendit të Komunës Rexhep Kurtbogaj.

Kupa, kapitenit Agron Nikqi, iu dorëzua nga presidenti i FVK-së Bahri Gjinovci

Ky ishte titulli i shtatë i kampionit për KV Peja, njëherit i katërti rradhazi.

FVK e përgëzon KV Peja për suksesin e arritur, duke e fituar trofeun e katërt sivjet, pas Kupës së Republikës, Kupës Pavarësia dhe Kupës së Federatës.



MBYLLET KAMPIONATI U22 NË BEACH VOLLEY

7 Maj, 2024

Me organizim të Federatës së Volejbollit të Kosovës (FVK), pas dy ditë garash, të martën është mbyllur edhe kampionati i grupmoshës U22

20 ekipe pjesëmarrëse, 8 te femrat e 12 te meshkujt, i kanë dhënë kësaj gare sharm, rivalitet dhe konkurencë, në kërkim të titullit të kampionit.

Në fushat e Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit (FEFS), në konkurencën e meshkujve u zhvilluan 19 ndeshje, si dhe 13 te femrat, me gjithsej 32 ndeshje në këtë kampionat.

Të martën u zhvilluan gjysmëfinalet e finalet, të cilat i nxorrën edhe çiftet kampione.

Te femrat u shpallën kampione Yllka Jashari e Melirona Avdullahu, të cilat në finale mposhtën dyshen Floriana Berisha e Erona Qerreti, ndërsa vendi i tretë i takoi dyshes Erëza Rushiti/Altuna Ibrahimi.

Në konkurencën e djemve Erion Bajrami e Eron Murseli patën paraqitjen më të mirë, duke u shpallur kampionë të kësaj grupmoshe.

Ata në finale e mposhtën dyshen Enes Shabani/Yll Salihu.

Në vendin e tretë te djemtë u rangua ekipi Dilon Latifaj e Erind Qalaj.

Ekipeve fituese, Kupën e kampionëve dhe medaljet ua dorëzuan presidenti i FVK-së Bahri Gjinovci dhe sekretari i përgjithshëm Valon Nikqi.

Ky ishte kampionati i parë i Kosovës në BeachVolley për këtë vit, si dhe do të vazhdojë me garat U18, U20 dhe te seniorët.



DRITA, KAMPION I KOSOVËS PËR HERË TË TETË

09 Maj, 2024

Drita e ka festuar titullin e tetë të kampionit në Raiffeisen Superligën A në volejbollin e femrave.

Për herë të parë në katër finale të luajtura mes Dritës e Skenderajt, fituesi u përcaktua në tre sete.

Në një atmosferë të zjarrtë në "Ilaz Kodra" të Skenderajt, Drita dukej ajo e pjesës së rregullt të kampionatit, kur fitoi 3-0, në sete 25:17; 25:22 dhe 25:18.

Sikurse edhe tri takimet tjera të serisë së finaleve, edhe në të katërtin, u pa konkurencë dhe spektakël në parket. Ky është trofeu i katërt për Dritën sivjet, pas Kupës së Republikës, Kupës Pavarësia dhe Kupës së Federatës.

Trofeun e kampionit, kapitenes Adelajda Prenga, ia dorëzoi presidenti i FVK-së Bahri Gjinovci,

Në ndarjet e medaljeve të arta e argjendta, i pari i FVK-së u shoqërua nga sekretari i përgjithshëm Valon Nikqi, zv. Presidentja e FVK-së Mimoza Shkodra Bislimi, anëtarët e bordit Dibran Kastrati e Abedin Mehani, drejtorët e sportit në Gjilan e Skenderaj, Kushtrim Zeqiri e Alban Berisha, si dhe kryetari i KV Skenderaj Afrim Durmishi.

FVK e përgëzon Dritën për suksesin e arritur, e poashtu Skenderajn për paraqitjet e mira, që i dhanë sharm e reflektuan cilësi të lartë në elitën e volejbollit kosovar.





NUMËR REKORD I EKIPEVE NË BEACH VOLLEY U18

17 Maj, 2024

47 kipe janë paraqitur për pjesëmarrje në garën e Kampionatit U18 në beach volley. Një numër kaq i madh ka ardhur nga organizimet e suksesshme të viteve të fundit dhe interesimit gjithnjë e më të madh të të rinjëve për të garuar në disiplinën olimpike të beach volley.



Koordinatori i garave në beach volley, Lorik Ilazi, me të konfirmuar ekipet e paraqitura, e ka prezantuar edhe orarin e fillimit të kësaj gare, e cila nis të shtunën në Holiday Resort në Sllatinë.

25 ekipe janë paraqitur te femrat dhe 22 tjera te meshkujt, që do të sjellin dy ditë të bukura të këtij kampionati në beach volley.

MBYLLET KAMPIONATI U18 NË BEACH VOLLEY

19 Maj, 2024

Pas dy ditëve maratonike janë mësuar edhe kampionët e grupmoshës U18 në beach volleyball, në të dyja konkurencat.

Në ambientet e Holiday Resort në Sllatinë, 42 ekipe, 25 te femrat dhe 17 te meshkujt, kanë sjellë garë rivalizuese.

Te meshkujt turneu u zhvillua në sistemin me eliminiminin të dyfishtë me formulën e 24

My travel
agrotrade
AGRIBAU
www.agribau.com
ARRBI
VLERA

ekipeve pasi që ishin pjesëmarrëse 17 sosh.

32 ndeshje u regjistruan te djemtë, për t'i nxjerrë kampionët e rinjë të kësaj grupmoshe.

Rangimi final te meshkujt ishte ky:

1. Donat GËRGURI/Erind QALAJ
2. Yll VESELAJ/Erion GASHI
3. Art BERISHA/Orges LAHU

Te femrat turneu u zhvillua me sistemin me eliminiminin të dyfishtë me formulën e 24 ekipeve, pasi ishin paraqitur 25 ekipe, kurse dy prej tyre luajtën për kualifikim

Te femrat, rangimi final ishte ky:

1. Sara PIRA/Alea DEMOLLI
2. Fjona SHALA/Enda XHAKOLLI
3. Elizabeta GASHI/Elona SALLAUKA





Gjithsejt në konkurrencën te femrat ne program ishin 47 ndeshje, ku 44 ndeshjet u arritën nga rezultatet në fushë dhe 3 ndeshje me rezultat zyrtar 2 me 0 (21:0, 21:0)

Në turne u zhvilluan gjithsej 76 ndeshje dhe atë 32 te meshkujt dhe 44 te femrat në dy fushat që janë ekzistuese në te ambientet e Holiday Resort në Sllatinë.

Kupat për ekipet kampione u ndanë nga presidenti i FVK-së Bahri Gjinovci, kurse medaljet nga sekrerari i përgjithshëm Valon Nikqi dhe drejtori i Holiday Resort Sadik Gashi.

INTERESIM I MADH PËR BEACH VOLLEY U20

24 Maj, 2024

Koordinatori i garave të beach-volley, Lorik Ilazi, e ka publikuar listën e plotë të aplikimeve të pranuara, për kampionatin U20 në beach volley. Gara që mbahet në fundjavë, më 25/26 maj 2024, sjell në aksion 43 ekipe, 25 te djemtë dhe 18 te vajzat.



Kjo është gara e tretë në këtë sezonë në beach volley , pas atyre në grupmoshat U22 dhe U18.

MBYLLET KAMPIONATI U20 NË BEACH VOLLEY

26 Maj, 2024

Pas dy ditëve të ngjeshura me maratonike janë mësuar edhe kampionët e grupmoshës U20 në beach volleyball, në të dyja konkurencat.

Në ambientet e Holiday Resort në Sllatinë, 37 ekipe, 17 te femrat dhe 20 te meshkujt, kanë sjellë garë rivalizuese.

Te meshkujt turneu u zhvillua me sistemin me eliminim të dyfishtë me formulën e 24 ekipeve, ku u zhvilluan 38 ndeshje, 35 prej të cilave u arritën nga rezultatet në fushë, kurse 3 ndeshje me rezultat zyrtar 2 me 0 (21:0, 21:0).

Te femrat turneu u zhvillua me sistemin e eliminimit të dyfishtë me formulën e 16 ekipeve, ku 2 skuadra luajtën për parakualifikim.

Gjithsejt në konkurrencën te femrat në program ishin 31 ndeshje, ku 30 ndeshje u arritën nga rezultatet në fushë dhe 1 ndeshje me rezultat zyrtar 2 me 0 (21:0, 21:0)

Në turne u zhvilluan gjithsejt 65 ndeshje dhe atë 35 te meshkujt dhe 30 te femrat në dy fushat e Holiday Resort në Sllatinë.

Renditja e ekipeve në podium ishte:

🏐 Femrat:

🥇 Fjona SHALA/Enda XHAKOLLI

🥈 Vesa BEQA/Rina MURTEZI

🥉 Sara PIRA/Olta AHMETI

🏐 Meshkujt:

🥇 Dilon LATIFAJ/Erind QALAJ

🥈 Donat GËRGURI/Erion GASHI

🥉 Doris GASHI/Ylli VESELAJ





Kupat për më të mirët, u ndanë nga presidenti i FVK-së Bahri Gjinovci, kurse medaljet nga nënkryetarja e FVK-së Mimoza Shkodra Bislimi, sekretari i përgjithshëm Valon Nikçi dhe drejtori i Holiday Resort Sadik Gashi.

GRUMBULLOHEN KOMBËTARET A

27 Maj, 2024

Kombëtaret e të dyja konkurencave do të grumbullohen të enjten dhe të premten, për të nisur edhe zyrtarisht përgatitjet për kualifikimet e CEV EuroVolley.

Të enjten në Fakultetin e Edukimit Fizik e Sportit (FEFS) do të bëhet grumbullimi i Kombëtares A te djemtë, kurse të premten në të njëjtën sallë, është planifikuar grumbullimi i "Dardaneve".



Në të dyja gjinitë, Kosovën e presin sfida serioze.

Te meshkujt, Kosova është në grup me Sllovakinë e Letoninë.

Ndeshjen e parë "Dardanet" e zhvillojnë para publikut vendas, më 17/18 gusht 2024, përballë Letonisë.

Te femrat, Kosova është në grup me Rumaninë e Kroacinë, poashtu dy rivalë shumë cilësorë.

Volejbollistet tona e hapin kampanjën e kualifikimeve në ndeshjen me Kroacinë, të cilën e luajnë si vendase, më 17/18 gusht 2024.

Federata e Volejbollit e Kosovës (FVK) është e përkushtuar për ta bërë më të mirën, që djemtë e vajzat tona, të na përfaqësojnë në mënyrën më të mirë në kualifikimet për CEV EuroVolley.

FVK u uron shumë suksese ekipeve tona Kombëtare, duke kontribuar direkt në mbështetjen e grumbullimeve dhe çdo formë tjetër, që ekipet tona ta kenë paraqitjen sa më dinjitoze.

PUBLIKOHET LISTA E KOMBËTARES SË VAJZAVE

28 Maj, 2024

Përzgjedhësi Lorik Ilazi, e ka bërë publike listën e gjerë të vajzave të ftuara në Kombëtaren e Kosovës në volejboll.

Në grumbullimin e së premtes më 31 maj 2024, Ilazi ka ftuar 26 lojtare, bazuar në formën e tyre në ekipet e Superligës së Kosovës dhe asaj të Shqipërisë.



FVK u uron shumë suksese ekipeve tona Kombëtare, duke kontribuar direkt në mbështetjen e grumbullimeve dhe çdo formë tjetër, që ekipet tona ta kenë paraqitjen sa më dinjitoze.

ZBULOHET LISTA E KOMBËTARES SË DJEMVE

28 Maj, 2024

Është bërë publike lista e gjerë e volejbollistëve të ftuar për kampanjën kualifikuese për CEV EuroVolley.

Në prag të kualifikimeve që do të nisin me 17 gusht 2024, me ndeshjen e parë që Dardanët e luajnë në Gjilan, ndaj Letonisë.



Në grumbullimin e së enjtes më 30 maj 2024, janë ftuar lojtarë të cilët janë duke gëzuar formë të mirë.

Grumbullimi mbahet në ambientet e FEFS në Prishtinë, nga ora 16:00.

Ky grumbullim do të vie në kohën, kur së shpejti do të publikohet emri i përzgjedhësit të ri të Kombëtares së djemve, te e cila do të vazhdojë punën si asistent edhe Faton Mustafa.

FVK u uron shumë suksese ekipeve tona Kombëtare, duke u qëndruar afër për t'u siguruar që do të kemi së bashku, rrugëtim të suksesshëm e dinjitoz.

MARTIN NEMEC, PËRZGJEDHËS I RI I KOSOVËS NË VOLEJBOLL

28 Maj, 2024

Federata e Volejbollit e Kosovës ka arritur marrëveshje duke emëruar sllovakun, Martin Nemec, si përzgjedhës i ri i Kombëtares së Kosovës në volejboll.

Ky është një hap i rëndësishëm për përforcimin e ekipit kombëtar dhe rritjen e nivelit të volejbollit në vend. Martin Nemec është një emër i njohur në botën e volejbollit. Me një karrierë të gjatë dhe të suksesshme si lojtar dhe trajner, Nemec sjell me vete një përvojë të gjerë ndërkombëtare.



Ai ka luajtur për disa prej ekipeve më të mira në Evropë dhe ka trajnuar ekipe në ligat më të njohura të kontinentit.

Përveç kësaj, ai është njohur për aftësitë e tij taktike dhe për qasjen e tij inovative ndaj stërvitjes dhe zhvillimit të lojtarëve.

Në një deklaratë të bërë sot, Nemec shprehu entuziazmin e tij për sfidën e re: "Jam i nderuar dhe i emocionuar që jam emëruar përzgjedhës i Kombëtares së Kosovës në volejboll. E shoh një potencial të madh në këtë ekip dhe jam i përkushtuar që të punoj fort për të arritur sukseset që meriton ky vend."

Ky emërim shënon një hap të ri për zhvillimin e sportit të volejbollit në Kosovë dhe Federata shpreson që me përvojën dhe udhëheqjen e Nemec, Kombëtarja do të arrijë rezultate të shkëlqyera në kompeticionet e ardhshme ndërkombëtare.

FINALET U16

28 Maj, 2024

Palestra “13 Qershori” në Suharekë do t’i presë ndeshjet e fazës finale, me katër ekipet e mbetura në garë.

Prishtina Elite, Theranda, Suti Sport e Malisheva, e vazhdojnë garën deri në kurorëzimin me trofeun kryesor.





Finalja e kampionatit U16 në volejboll te djemtë, e sjell duelin e dy skuadrave që kanë patur rrugëtimin më të mirë deri në këtë fazë.

Vëllaznimi e Skënderbeu, ndeshen në ballafaqimin e drejtpërdrejt për titullin e kampionit të U16.

Ndeshja zhvillohet në Pallatin e Sporteve “13 Qershori” në Suharekë.

NË FUNDJAVË KAMPIONATI I SENIORËVE NË BEACH VOLLEY

31 Maj, 2024

Gara e katërt e sezonit dhe e fundit në serinë e kampionateve të Kosovës në beach volley, do të sjellë në aksion ekipet e seniorëve.



Të shtunën dhe të dielën në Holiday Resort në Sllatinë pritet një tjetër spektakël i volejbollit.

22 ekipe, prej të cilave 15 te meshkujt dhe 7 te femrat, do të sjellin rivalitet, për të marrë trofeun kryesor. Finalet do të zhvillohen të dielën nga ora 15:00, si dhe do të transmetohen drejtpërdrejt në RTK1.

MBYLLET SUPER SHFAQJA E BEACH VOLLEY

02 Qershor, 2024

Për dy ditë gjatë fundjavës, janë mbyllur edhe garat e kategorisë së seniorëve në Beach Volley.

Pas së shtunës, e cila ishte e dedikuar për ndeshjet preliminare, të dielën aksioni ka vazhduar me ndeshjet interesante të fazës finale.

Finalet e të dyja konkurencave, sollën ndeshje interesante dhe volejboll cilësor.

Në një ambient të bukur në Holiday Resort, ky organizim dhe cilësia u shfaq edhe përmes Radiotelevizionit të Kosovës, për të gjithë adhuruesit që nuk e patën këtë mundësi ta ndiqnin nga ky ambient.

Finalet nga afër i përcolli edhe presidenti i Komitetit Olimlik të Kosovës, Ismet Krasniqi, i cili shoqërohej nga presidenti i Federatës së Volejbollit të Kosovës (FVK) Bahri Gjinovci, sekretari i përgjithshëm Valon Nikqi dhe personalitete tjera, që i dhanë madhështi kësaj gare.

Te djemtë çifti Ermal Maliqi/Erion Bajrami e fitoi finalen, ndaj dyshes Shkëlqim Ismajli/Valmir Demi.



Vendin e tretë te djemtë e zuri dyshja Adriatik Berisha/Rilind Gashi.

Në konkurencën e vajzave, vendi i parë i takoi Valmira Ramadanit e Lorisa Avdylit, që në finale ishin më të mira sesa çifti ferizajas Melirona Avdullahu e Yllka Jashari.



Vendin e tretë te vajzat e zuri dyshja Adelajda Prenga/Amela Llugaliu.

Kjo ishte gara e katërt dhe e fundit në serinë e kampionateve të Kosovës, të organizuara nga FVK-ja, pas garave në grupmoshat U18, U20 dhe U22.

Medaljet dhe trofeun fituesve ua ndau presidenti i FVK-së Bahri Gjinovci, i shoqëruar nga presidenti i KOK-ut Ismet Krasniqi, si dhe sekretari i përgjithshëm i FVK-së Valon Nikqi.

KV SKËNDERBEU U16 KAMPION I KOSOVËS

02 Qershor, 2024

Djemtë e KV Skënderbeu U16, janë shpallur kampion të Kosovës në këtë grupmoshë, pasi në finalen përcaktuese për titull, e mposhtën KV Vëllaznimi U16, me rezultat 2:0 (25:21, 26:24).

Ndeshja e zhvilluar në Pallatin e Sporteve “13 Qershori” në Suharekë, ishte mjaft interesante dhe rivalizuese.



FVK e përgëzon KV Skënderbeu U16 për suksesin e arritur dhe KV GE Theranda për organizimin e turneut final të kësaj grupmoshe.

KV SUTI SPORT KAMPION I U16 TE VAJZAT

02 Qershor, 2024

Klubi pejan KV Suti Sport, e ka arritur edhe një sukses tjetër te kategoritë e reja, këtë herë duke u shpallur kampion i grupmoshës U16.

Në një atmosferë të bukur në Pallatin e Sporteve “13 Qershori” në Suharekë, KV Suti Sport, arriti që në finale të triumfojë ndaj KV GE Theranda, me rezultat 2:0 (25:19; 25:19).

Vendin e tretë e fitoi KV Malisheva U16, e cila në ndeshjen për këtë pozitë triumfoi ndaj Prishtina Elite U16, me rezultat 2:0 (25:18; 29:27).





Kupën, kampioneve ia dorëzoi ish-presidenti i FVK-së Xhavit Mustafa, kurse medaljet u ndanë nga trajneri turk i Kombëtare U20, si dhe z.Gazmend Husaj dhe z.Hysen Gashi.

FVK e përgëzon KV Suti Sport U16 për suksesin e arritur, e poashtu edhe KV GE Theranda, për organizimin e mirë të turneut final të grupmoshës U16.

KOSOVA NË CEV U22 BEACH VOLLEY

5 Qershor, 2024

Dy çiftet kosovare, nga e enjtja, do të nisin garat në CEV Kampionatin Evropian në beach volley, që do të mbahet nga 6-9 qershor në Termal, Yalova, afër Izmirit në Turqi.

Kosova përfaqësohet me dyshet Erion Bajrami/Eron Murseli te djemtë, që udhëhiqen nga trajneri Fatlum Hajrizi, si dhe Yllka Jashari/Melirona Avdullahu, që udhëhiqen nga trajneri Edon Ibrahimi.

Djemtë do ta kenë në program një ndeshje të enjten (me Turqinë), kurse vajzat i luajnë dy (me Holandën dhe Ukrainën).

Çiftet kosovare kanë arritur në Turqi dhe janë gati për sfidat që i presin.

FVK u uron shumë suksese djemve e vajzave tona, në paraqitjet e tyre në CEV U22 Kampionatin Evropian në beach volley.

KRASNIQI E MUSTAFA, PJESË E KAMPIT TË KOMBËTARES ITALIANE U22

6 Qershor, 2024

Dy trajnerët kosovarë të volejbollit, Naser Krasniqi dhe Faton Mustafa, janë duke qëndruar në Itali, ku po ndjekin nga afër grumbullimin e Kombëtares U22 të Italisë.

Në kuadër të bashkëpunimit mes Federatës së Volejbollit të Kosovës dhe asaj Italiane, Krasniqi dhe Mustafa janë trajnerët e radhës që përfitojnë nga kjo marrëveshje e këmbimit të përvojave, në një vend si Italia që cilësohet si superfuqi në sportin e rrjetës.



Eksperiencat e strategëve italianë do të jenë të mirëseardhura për trajnerët tanë dhe kjo pritet t'i sjellë rezultate në performancën e ekipeve dhe volejbollit tonë.

Grumbullimi po zhvillohet në Trento të Italisë, duke ofruar një ambient ideal për të mësuar dhe për të përfituar nga metodat dhe taktikat e avancuara të volejbollit italian. Ky shkëmbim përvojash synon të forcojë më tej kapacitetet e trajnerëve tanë dhe të kontribuojë në ngritjen e cilësisë së volejbollit në Kosovë.

KOSOVA E SHBA, AFËR EDHE PËRMES VOLEJBOLLIT

9 Qershor, 2024

Ekipi i Unionit Amator të Sporteve (AAU) të Ioëa-s, ka zhvilluar një ndeshje miqësore me ekipin e KV Prishtina Elite.

Në atmosferë të jashtëzakonshme miqësore, të dyja palët e kanë mirëpritur këtë takim, i cili ka për qëllim afrimin edhe më të madh mes dy vendeve, përmes volejbollit.

Në emër të FVK-së, sekretari i përgjithshëm i FVK-së Valon Nikqi, ka ndarë për pjesëmarrësit, disa dhurata simbolike.



Përfaqësuesja e AAU Ioëa znj. Teresa Parmenter, poashtu shkëmbeu dhurata, duke shprehur entuziazmin e saj për mikpritjen dhe nivelin e organizimit të volejbollit, në vendin tonë.

Përmes volejbollit dhe sporteve tjera, delegacione të AAU Ioëa po qëndrojnë në Kosovë, duke ofruar përvojën dhe gadishmërinë e tyre për t'i qëndruar afër Kosovës dhe sportit të vendit tonë.

TURNEU I BEACH VOLLEY "FUSHE KOSOVA OPEN"

11 Qershor, 2024

Sot ka nisur turneu i beach volley-t, i organizuar nga KV Fushë Kosova Volley, si dhe mbështetur nga Komuna e Fushë Kosovës në bashkëpunim me Federatën e Volejbollit të Kosovës (FVK) dhe Shoqatën e Pedagogëve Sportiv të Fushë Kosovës.

Turneu po zhvillohet në terrenet sportive të qytetit dhe pritet të sjellë një atmosferë dinamike dhe kompetitive për sportdashësit.

Në këtë turne marrin pjesë 14 ekipe, të ndara në dy kategori: 8 ekipe të meshkujve dhe 6 ekipe të femrave. Garat e ditës së parë u ndoqën nga afër nga figura të rëndësishme të volejbollit kosovar, përfshirë Presidentin e FVK-së Bahri Gjinovci, sekretarin e përgjithshëm Valon Nikqi dhe afaristin Faton Paçarada nga kompania sponsore e FVK-së.

Të pranishmit vlerësuan organizimin dhe nivelin e lartë të konkurencës, duke e cilësuar këtë event si një mundësi të shkëlqyer për promovimin e volejbollit në Kosovë.



Ndeshjet do të vazhdojnë edhe nesër, kur do të zhvillohen finalet e turneut.

Pritet një spektakël i vërtetë, pasi ekipet më të mira do të konkurrojnë për titullin e kampionit.

Turneu i beach volley ka tërhequr vëmendjen e shumë tifozëve dhe familjarëve, të cilët kanë ardhur për të mbështetur ekipet e tyre të preferuara.

Ky event është një mundësi e shkëlqyer për komunitetin që të bashkohet dhe të festojë sportin e volejbollit.

Organizatorët shpresojnë që ky turne të bëhet një traditë e përvjetshme, duke kontribuar në rritjen dhe zhvillimin e volejbollit në Kosovë.

FUNDJAVA I PËRCAKTON KAMPIONËT NË U14

11 Qershor, 2024

Në palestrën "Suti Sport" në Pejë, të shtunën përcaktohen emrat e ekipeve kampione në të dyja grupmoshat.

Te vajzat do të jenë dy ndeshje, përfshirë atë për vendin e tretë mes KV Fushë Kosova Volley dhe Theranda.



Ndërkohë finalja e meshkujve luhet në 12:30h, mes Vëllaznimit e Skënderbeut, kurse ajo e femrave nga 14.00h, mes Vëllaznimit dhe Suti Sport.

FVK u uron suksese të gjitha ekipeve të mbetura në garë dhe i përgëzon për përkushtimin për të rritur cilësinë e volejbollit, nga dita në ditë.

KV SKËNDERBEU KAMPION NË U14 (M)

15 Qershor, 2024

KV Skënderbeu nga Kraishta e Lipjanit, është fitues i edicionit të sivjemë në kampionatin e grupmoshës U14.

Djemtë e KV Skënderbeu e fituan finalen ndaj KV Vëllaznimi, me rezultat 2:0.

Vendin e tretë e zuri skuadra e KV Feronikeli, e cila arriti të hyjë në mesin e ekipeve më të mira.

Kupën, ekipit kampion ia dorëzoi presidenti i FVK-së Bahri Gjinovci.



Medaljet e arta u ndanë nga z. Ilir Dedushi, kurse të argjendtat nga z. Hysen Gashi.

FVK e përgëzon KV Skënderbeu për suksesin e arritur, si dhe të gjitha ekipet pjesëmarrëse, për përkushtimin dhe punën.

KV SUTI SPORT KAMPION NË U14

15 Qershor, 2024

KV Suti Sport nga Peja (femrat) u shpall kampion të grupmoshës U14, në garën finale të zhvilluar të shtunën.

Vajzat e KV Suti Sport e mposhtën skuadrën e Vëllaznimit me rezultat 2:0.

Në ndeshjen për vendin e tretë Fushë Klsova Volley, triumfoi ndaj KV Theranda, poashtu me rezultat 2:0.

Kupën, ekipit kampion ia dorëzoi presidenti i FVK-së Bahri Gjinovci i shoqëruar nga presidenti i KV Suti Sport, Hysen Gashi.





Medaljet u ndanë nga zotërinjtë Bahri Gjinovci, Hysen Gashi, Ardian Ibraj e Burim Zymeri.

FVK e përgëzon KV Suti Sport për suksesin e arritur, si dhe të gjitha ekipet pjesëmarrëse, për përkushtimin dhe punën.

NIKQI, SUPERVAJZER NË KAMPIONATIN BALLKANIK

18 Qershor, 2024

Valon Nikqi është përcaktuar në mesin e supervajzerëve të BVA Kampionatit Ballkanik U18, që ka filluar në Tiranë. Nikqi, që edhe më herët ka qenë pjesë e garave të ndryshme ballkanike dhe evropiane për klube, në të njëjtën cilësi, ka marrë ftesën e BVA-së që të jetë pjesë e kësaj gare.



Kampionati Ballkanik U18 për Femra 2024 do të luhet nga data 18 deri më 22 qershor në Tiranë dhe organizohet nga Federata e Volejbollit të Shqipërisë.

Në Kampionatin Ballkanik U18 për Femra marrin pjesë Shqipëria, Bullgaria, Rumania dhe Maqedonia e Veriut në grupin A, ndërsa Turqia, Serbia, Mali i Zi dhe Moldavia në grupin B.

KADRIU E IBRAHIMI E MBYLLIN KAMPIN NË CAVALESSE

26 Qershor, 2024

Trajnerët kosovarë Ylli Kadriu dhe Edon Ibrahimi e kanë mbyllur kampin ku ishin pjesë e grupit të tretë të trajnerëve nga Kosova, që janë që oanë nga afër punën që bëhet në kombëtaren U22 të Italisë. Në kuadër të bashkëpunimit të Federatës së Volejbollit të Kosovës dhe asaj Italiane të Volejbollit, pas dy grupeve të para të trajnerëve Lorik Ilazi, Blend Haxhikadrija, Naser Krasniqi dhe Faton Mustafa, po vazhdohet i njëjti bashkëpunim me grupin e tretë.

Trajnerët kosovarë patën mundësi ideale të përfitojnë nga standardi i lartë që përfaqësojnë strategët më të mirë italianë, të angazhuar në kombëtaren e “azzureve”.



Përveç Kombëtares U22, trajnerët Kadriu e Ibrahimi, ndoqën nga afër edhe përgatitjet e Kombëtares A të Italisë.

Kampi u mbajt në Cavalesse të Italisë dhe ky projekt mes Federatës Kosovare dhe asaj Italiane, do të shtrihet edhe në nivelin e administratorëve dhe menaxherëve të volejbollit.

PARAQITET LISTA FINALE E 14 VOLEJBOLLISTEVE TË KOMBËTARES SË VAJZAVE

28 Qershor, 2024

Përzgjedhësi Lorik Ilazi ka prezantuar formacionin e 14 lojtareve, të cilave do t'u besohet kampanja e kualifikimeve për CEV EuroVolley 2026.



Grumbullimi do të zhvillohet në qytetin e Gjilanit, ndërsa lista finale e volejbollisteve të ftuara është si më poshtë:

Pasuese:

1. Blinera JAHA - KV Fushë Kosova
2. Zyla KADRIU - KS Skënderbeu

Korrektore:

1. Amela LLUGALIU - KV Prishtina 75
2. Loresa AVDYLI - KV Drita

Qendër:

1. Bleona KADRJA - KV Skënderaj
2. Leonita HOXHA - KV Skënderaj
3. Valmira RAMADANI - KV Drita
4. Vesa SHABANI - KV Fushë Kosova

Pranuese:

1. Dhuratë SYLEJMANI - KV Drita

2. Egzona GECI - KV Skënderaj

3. Rinesa HASANI - KV Fer Volley

4. Venerë KADRIU - KV Drita

Libero:

1. Adelajda PRENGA - KV Drita

2. Hyrije GOXHULI - KV Skënderaj

GRUMBULLIMI I DYTË I KOMBËTARES SË DJEMVE

30 Qershor, 2024

Përzgjedhësi i Kombëtares në volejboll, Martin Nemec, ka zhvilluar grumbullimin e radhës me djemtë e kombëtares në palestrën e Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit.

Ky grumbullim është një hap i rëndësishëm për përgatitjen e skuadrës për sfidat e ardhshme, sidomos për kualifikimet për CEV EuroVolley.

Nemec ka vendosur theks të veçantë tek matjet e performancës së volejbollistëve përmes pajisjeve të sofistikuara.



Këto matje janë thelbësore për të analizuar dhe përmirësuar aftësitë fizike dhe teknike të lojtarëve.

Pajisjet e avancuara teknologjike lejojnë një vlerësim të detajuar të shpejtësisë, fuqisë, kërcimit dhe koordinimit të secilit lojtar.

Këto të dhëna ndihmojnë stafin teknik të identifikojë pikat e forta dhe dobësitë e secilit sportist, duke mundësuar një planifikim më të mirë të stërvitjeve dhe strategjive për ndeshjet e ardhshme.

Grumbullimi, që do të zgjasë pesë ditë, është i dyti pas ardhjes së përzgjedhësit Martin Nemec në krye të Kombëtares dhe ka për qëllim të komponojë një ekip sa më të fortë dhe të harmonizuar.

Nemec i asistuar nga trajneri kondicional Andrej Prandorfy dhe ndihmëstrajneri Skender Lajçi, do të vazhdojnë punën me këto grumbullime deri më 5 korrik, për ta mbyllur këtë cikël, e duke bërë planin për grumbullimin e rradhës.



Përzgjedhja e lojtarëve më të mirë dhe krijimi i një skuadre të unifikuar është thelbësore për suksesin në arenën ndërkombëtare.

Përmes këtyre seancave intensive stërvitore, Nemec synon të krijojë një skuadër të disiplinuar dhe të koordinuar, e cila do të jetë gati për të përballuar kundërshtarët e fortë në kualifikimet për CEV Eurovolley.

Te meshkujt, Kosova është në grup me Sllovakinë dhe Letoninë.

Ndeshjen e parë "Dardanët" e zhvillojnë para publikut vendas në Gjilan më 17 gusht 2024, përballë Letonisë.

Kjo ndeshje do të jetë një test i rëndësishëm për skuadrën dhe një mundësi për të treguar progresin e bërë gjatë këtyre grumbullimeve intensive.

Me një përgatitje të mirë dhe një skuadër të fortë, Kosova synon të sigurojë një performancë të suksesshme në këto kualifikime të rëndësishme.

SUPER ATMOSFERË TE KOMBËTARJA E VAJZAVE

30 Qershor, 2024

Qyteti i Gjilanit ka qenë ndalesa e radhës në grumbullimin e Kombëtares së vajzave në volejboll.

Përzgjedhësi Lorik Ilazi ka mbledhur 14 lojtare të përzgjedhura, të cilat për dy ditë, për rreth 10 orë punë intensive, kanë zhvilluar përgatitje serioze në prag të sfidave për kualifikimet në CEV EuroVolley, që do të zhvillohen në gjysmën e dytë të gushtit.

Atmosfera pozitive, disponimi dhe përkushtimi serioz kanë qenë të pranishme gjatë këtij grumbullimi, që është mbajtur në Pallatin e Sporteve "Bashkim Selishta-Petriti" në Gjilan.

Volejbollistet tona po punojnë me përkushtim për të qenë sa më të përgatitura për përballjet e ardhshme.



Te femrat, Kosova është në grup me Rumaninë dhe Kroacinë, dy rivalë shumë cilësorë. Kampanja e kualifikimeve do të hapet me ndeshjen ndaj Kroacisë, e cila do të luhet si vendase më 17 gusht 2024, nga ora 20:00 në Gjilan.

Federata e Volejbollit e Kosovës (FVK) është e përkushtuar për të bërë më të mirën që djemtë dhe vajzat tona të na përfaqësojnë në mënyrën më të mirë në kualifikimet për CEV EuroVolley.

FVK ka investuar në trajnime intensive dhe përgatitje të detajuara për të siguruar që skuadrat tona të jenë të gatshme për sfidat e ardhshme dhe të japin performancën më të mirë të mundshme në arenën ndërkombëtare.

NIS FIVB KURSI TEKNIK PËR TRAJNERË - NIVELI 2

1 Korrik, 2024

Sot ka filluar niveli i dytë i kursit teknik për trajnerët e volejbollit, një iniciativë e mbështetur nga Komiteti Olimpik i Kosovës (KOK) përmes fondit të Solidaritetit Olimpik të Komitetit Olimpik Ndërkombëtar (IOC).

Kursi po mirëpret dhjetëra trajnerë të volejbollit, të cilët do të kenë mundësinë të përfitojnë nga përvoja dhe njohuritë e ligjëruesve të njohur Martin Nemec dhe Andrej Prandorfy nga Sllovakia.

Ky trajnim do të zgjasë deri më 5 korrik dhe përfshin sesione teorike dhe praktike, duke siguruar një përgatitje të plotë dhe gjithëpërfshirëse për trajnerët.



Pjesa teorike mbahet në Holiday Resort në Sllatinë, kurse ajo praktike në palestrën e Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit (FEFS).

Kjo nismë është një hap i rëndësishëm për zhvillimin e volejbollit në Kosovë, duke ngritur nivelin e trajnerëve dhe duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë së sportit në vend.

Trajnerët pjesëmarrës do të kenë mundësinë të thellojnë njohuritë e tyre dhe të ndajnë praktikat më të mira, duke përmirësuar kështu performancën e ekipeve që ata drejtojnë.

PËR TË TRETIN VIT, NDEROHET GENC ZYBA

2 Korrik, 2024

Turneu memorial i volejbollit kushtuar ish-volejbollistit Genc Zyba do mbahet për të tretin vit radhazi në fshatin Bukosh.



Ky turne shërben si një homazh për kontributin e tij në sportin e volejbollit dhe mbledh entuziastë dhe sportistë nga i gjithë vendi për të nderuar kujtimin e tij.

Turneu fillon më 20 korrik dhe finalja mbahet më 25 korrik 2024.

Organizimi bëhet nga këshilli organizativ i fshatit Bukosh në bashkëpunim me Federatën e Volejbollit të Kosovës dhe Komunën e Suharekës.

MBYLLET GRUMBULLIMI I DYTË I KOMBËTARES SË DJEMVE

5 Korrik, 2024

Për 6 ditë me radhë, nën urdhrat e përzgjedhësit Martin Nemec, djemtë e kombëtares së Kosovës kanë zhvilluar stërvitje intensive në prag të kualifikimeve për CEV EuroVolley.

Nemec, i asistuar nga trajneri kondicional Andrej Prandorfy dhe zv. trajneri Skender Lajçi, e vazhduan punën me këto grumbullime deri sot, 5 korrik, për ta mbyllur këtë cikël dhe për të bërë planin për grumbullimin e radhës.



Në grupin e meshkujve, Kosova është përballur me Sllovakinë dhe Letoninë.

Kombëtaren e djemve, për disa ditë radhazi në këto përgatitje, e ka vizituar edhe presidenti i FVK-së, Bahri Gjinovci, duke treguar mbështetjen e tij të plotë.

Ndeshjen e parë "Dardanët" do ta zhvillojnë para publikut vendas në Gjilan më 17 gusht 2024, përballë Letonisë.

Pas këtij grumbullimi, do të mësohet lista e ngushtë 14 të ftuarve, të cilëve do t'u besohen kualifikimet.

MBYLLET KURSI I FIVB PËR TRAJNERË - NIVELI 2

5 Korrik, 2024

Ka përfunduar me sukses kursi teknik për trajnerët e volejbollit, niveli i dytë, i mbështetur nga KOK-u përmes fondit të Solidaritetit Olimpik të IOC.

Në kurs ligjëruan trajnerët Martin Nemec dhe Andrej Prandorfy nga Sllovakia.



Vijuesit e shumtë patën rastin të mësojnë nga përvoja e trajnerëve gjatë trajnimeve praktike dhe teorike, të cilat u mbajtën prej 1 deri më 5 korrik.

Në ceremoninë e ndarjes së certifikatave, të pranishëm ishin drejtuesit e FVK-së, kryetari Bahri Gjinovci e sekretari i përgjithshëm, Valon Nikqi, si dhe drejtuesit e Akademisë Olimpike, Fitim Arifi e Diellza Kelmendi.

KAMPIONËT E KOSOVËS NË BVA CUP

11 Korrik, 2024

KV Peja te djemtë dhe KV Drita te vajzat, do ta përfaqësojnë volejbollin Kosovar, përmes prezencës së tyre në BVA Kupën e Ballkanit.

Në grup me "Shqiponjat" nga Peja, do të jetë Pegasus Polichnis nga Greqia, që poashtu është edhe organizator i garës, së bashku me Arkas Sport Club nga Turqia, Beror 2016 nga Bullgaria dhe Radniçkin nga Serbia.





Data e fillimit të garave dhe palestra ku do të zhvillohen, akoma nuk janë bërë të ditura, e së shpejti ato do t'i specifikojë BVA.

Në konkurencën e vajzave, "Intelektualet" nga Gjilani do të jenë në grup nikoqirin e kësaj gare, Galatasaray nga Turqia, PAOK nga Greqia, ZOK Igman nga BeH dhe Zeleznicar nga Serbia.

Gara e BVA Kupës Ballkanike në konkurencën e vajzave, do të zhvillohet nga 13 deri më 15 shtator 2024 në Stamboll të Turqisë.

FVK u uron të dy kampionëve të Kosovës, shumë suksese në prezantimet e tyre në BVA Kupën Ballkanike.

VALON MUSTAFA NË KAMPIONATIN EVROPIAN U18 NË BEACH VOLLEY

12 Korrik, 2024

Gjyqtari Kosovar Valon Mustafa në Kampionatin Evropian U18 në Beach Volley

Valon Mustafa, gjyqtari i vetëm kosovar me thirrje ndërkombëtare në beach volley, po ndan drejtësinë në Kampionatin Evropian U18 në këtë sport. Pas përvojës së tij të suksesshme në Lojërat Mesdhetare në Rërë në shtatorin e vitit të kaluar, Mustafa tani po demonstron aftësitë dhe profesionalizmin e tij edhe në këtë kampionat të rëndësishëm evropian.



Gara po mbahet në Gjeorgji dhe Federata e Volejbollit të Kosovës (FVK) i uron shumë suksese Valon Mustafës në këtë sfidë të tij të dytë ndërkombëtare, ku i është besuar ndarja e drejtësisë.

KOSOVA TESTOHET NË MIQESORE NË SHQIPËRI

18 Korrik, 2024

Sot u zhvillua ndeshja e parë kontrolluese me Kombëtaren U20 të Shqipërisë, e cila këtë fundjavë do të jetë në garë në Ligën Ballkanike U20 dhe ka qenë për dy javë në përgatitje së bashku me ekipin e “azzureve” në Itali.



Kombëtarja jonë, pas ndeshjes së sotme dhe asaj të premten, nesër do të luajë përsëri ndeshjen miqësore me Shqipërinë U20.

Më 3 gusht do të vazhdohet me ndeshjet kontrolluese, duke udhëtuar në Malin e Zi për të luajtur me kombëtaren malazeze, e cila gjithashtu po përgatitet për kualifikimet për Evropianin 2026.

KAMPIONATI EVROPIAN U20 NË KATOËICE, POLONI

23 Korrik, 2024

Kosova do të marrë pjesë në CEV Kampionatin Evropian U20 në beach-volleyball që mbahet në Katoëice të Polonisë, me një ekip të talentuar dhe të motivuar për të arritur suksese.

Në ekipin e djemve, do të përfaqësohemi nga:

- Erind Qalaj

- Dilon Latifaj

- Trajneri Fatlum Hajrizi

Ekipi i vajzave përbëhet nga:

- Fjona Shala

- Enda Xhakolli

- Trajneri Elmi Zymeri



Nesër do të hidhet shorti për kualifikime, ku do të përcaktohen kundërshtarët e ardhshëm.

Jemi të sigurt që përfaqësuesit tanë do të japin më të mirën e tyre në këtë garë prestigjioze.

ÇIFTET KOSOVARE I MËSOJNË KUNDËRSHTARËT

23 Korrik, 2024

Në CEV Kampionatin Evropian U20 në beach volley, çiftet kosovare Fjona Shala dhe Enda Xhakolli, si dhe Erind Qalaj dhe Dion Latifaj, i kanë mësuar kundërshtarët e tyre.

Dyshja Shala/Xhakolli do të përballet me dyshen azere Latsabidze/Alizada.

Te djemtë, Qalaj dhe Latifaj do të ndeshen me dyshen tjetër nga Azerbajxhani, Nariman/Muhammad.

Federata e Volejbollit të Kosovës (FVK) u uron suksese ekipeve kosovare në Kampionatin Evropian U20 që po mbahet në Katoëice të Polonisë.

HUMBJE NË NDESHJET E PARA TË ÇIFTEVE TONA

24 Korrik, 2024

Në CEV Kampionatin Evropian U20 në beach volley, çiftet kosovare Fjona Shala dhe Enda Xhakolli, si dhe Erind Qalaj dhe Dion Latifaj, në ndeshjet e para kanë pësuar humbje.

Dyshja Shala/Xhakolli u mposht 2:0 (16:21; 15:21) nga dyshja azere Latsabidze/Alizada.



Ndeshjen e rradhës dyshja e vajzave tona do ta zhvillojë përballë skocezeve Bell/Clegg-McKeoën. Te djemtë, Qalaj dhe Latifaj poashtu u mposhtën 2:0 (11:21; 18:21) nga çifti tjetër nga Azerbajxhani, Nariman/Muhammad.



Zhvillimin e ndeshjeve e vështirësoi shiu, e reshje të tilla pritet të zgjasin tërë ditën në Katoëice të Polonisë, ku po zhvillohet kjo garë.

Kosova ka pësuar humbje në të dyja ndeshjet e grupit në CEV Kampionatin Evropian U20.

Në kategorinë e djemve, Kosova u mposht nga Rumania me rezultat 2:0 në sete, duke humbur me 21:11 dhe 21:12.

Ndërsa në kategorinë e vajzave, Skocia mundi Kosovën po ashtu me rezultat 2:0 në sete, me pikë 21:12 dhe 21:16. Këto humbje janë të dyta për çiftet e Kosovës në këtë kampionat.

GRUMBULLIMI I KOMBËTARES SË KOSOVËS NË VOLEJBOLL

28 Korrik, 2024

Përgatitjet për kualifikimet në CEV Eurovolley janë në kulmin e tyre!

Kombëtarja e Kosovës në volejboll ka nisur grumbullimin e saj me ndihmës trajnerët Skender Lajçi dhe Dardan Husaj, të cilët udhëhoqën stërvitjet dy ditore me sukses të madh.

Kombëtaren në këto stërvitje e ka vizituar edhe presidenti i FVK-së Bahri Gjinovci, i shoqëruar bga sekretari i përgjithshëm Valon Nikqi.

Pas këtij grumbullimi intensiv në fundjavë, Kombëtarja do të mblidhet përsëri nga data 3 gusht deri më 28 gusht 2024.



Trajneri Nemec synon të krijojë një skuadër të disiplinuar dhe të koordinuar, e cila do të jetë gati për të përballuar kundërshtarët e fortë në kualifikimet për CEV Eurovolley. Ndeshjet e Radhës

- Te meshkujt, Kosova është në grup me Sllovakinë dhe Letoninë.

- Ndeshjen e parë "Dardanët" do ta zhvillojnë para publikut vendas në Gjilan më 17 gusht 2024, ku do të përballen me Letoninë. Kjo ndeshje do të jetë një moment i rëndësishëm për ekipin tonë, që synon të fillojë me një fitore të madhe para tifozëve tanë të zjarrtë!

KOSOVA U20, PJESË E BVA BEACH VOLLEY

29 Korrik, 2024

Nga 1 deri më 4 gusht në Iasi të Rumanisë do të mbahet Kampionati Ballkanik i BVA në beach volley.

Në ekipin e djemve, do të përfaqësohemi nga:

- Erind Qalaj

- Dilon Latifaj

- Trajneri Fatlum Hajrizi

Ekipi i vajzave përbëhet nga:

- Fjona Shala

- Enda Xhakolli

- Trajneri Elmi Zymeri



Nga e diela ekipet janë grumbulluar në kamp, kurse më 30 korrik udhëtojnë drejt Rumanisë.

SONTE, MIQËSORJA MES MALIT TË ZI E KOSOVËS

2 Gusht 2024

Kombëtarja e Kosovës në konkurrencën e vajzave do të zhvillojë sonte një ndeshje miqësore kundër Malit të Zi, e cila do të fillojë në orën 20:00. Kjo ndeshje është pjesë e përgatitjeve intensive për kualifikimet e CEV EuroVolley, të cilat pritet të fillojnë më 17 gusht. Ndeshja miqësore do të zhvillohet në Bjelo Polje, në Mal të Zi.



Ky takim miqësor është një test serioz dhe i rëndësishëm për trajnerin dhe stafin teknik të Kombëtares së Kosovës, pasi do t'u japë mundësinë të vlerësojnë zhvillimin dhe përparimin e grupit të lojtarëve të grumbulluara deri më tani. Performanca në këtë ndeshje do të ndihmojë në identifikimin e pikave të forta dhe të dobëta të ekipit, duke mundësuar kështu përgatitje më të mirë për garat e ardhshme zyrtare.

Federata e Volejbollit të Kosovës (FVK) i uron shumë sukses Kombëtares së vajzave në këtë ndeshje dhe në rrugëtimin e tyre drejt kualifikimeve për EuroVolley. Ky është një moment i

rëndësishëm për ekipin dhe një mundësi e shkëlqyer për të treguar aftësitë dhe përgatitjen e tyre në arenën ndërkombëtare.

KOSOVA E FITON MIQËSOREN ME MALIN E ZI

Kombëtarja e vajzave në volejboll e Kosovës ka arritur një fitore të shkëlqyer në ndeshjen miqësore të zhvilluar sonte ndaj Malit të Zi, duke triumfuar me rezultatin bindës 3:0 në sete. Kjo ndeshje ishte pjesë e përgatitjeve për kualifikimet e CEV EuroVolley.

Nën drejtimin e përzgjedhësit Lorik Ilazi dhe stafit asistues teknik, ekipi tregoi një performancë të jashtëzakonshme në të tre setet, duke shfaqur talentin dhe përkushtimin e tyre.

Seti i parë ishte një paraqitje mbresëlënëse nga vajzat e Kosovës. Me një fillim të fuqishëm, ato arritën të krijojnë një avantazh të konsiderueshëm. Lojtarët shfaqën një koordinim të shkëlqyer në sulm dhe mbrojtje, duke mos lejuar kundërshtaret të gjenin ritmin.



Pikë pas pike, Kosova e ngriti avantazhin dhe e përfundoi setin me rezultatin 25:16. Përzgjedhësi Lorik Ilazi arriti të krijojë një strategji efikase, e cila u zbatua në mënyrë perfekte nga ekipi.

Seti i dytë pasqyroi performancën e parë, me vajzat e Kosovës që vazhduan të dominojnë fushën. Organizimi i shkëlqyer dhe komunikimi ndërmjet lojtarëve ishin kyç në këtë set. Edhe një herë, Kosova shfaqi një lojë të fortë dhe të qëndrueshme, duke mos i lënë asnjë hapësirë kundërshtareve për të rikuperuar. Seti u mbyll me të njëjtin rezultat si i pari, 25:16, duke dëshmuar përgatitjen e jashtëzakonshme të ekipit dhe udhëheqjen e shkëlqyer nga Lorik Ilazi.

Seti i tretë ishte më i ngushtë dhe sfidues, me Malin e Zi që përpiqej të rikthehej në lojë. Megjithatë, vajzat e Kosovës treguan durim dhe këmbëngulje, duke mbajtur nën kontroll situatën. Lufta për çdo pikë ishte intensive, por Kosova arriti të ruajë qetësinë dhe të sigurojë fitoren e setit me rezultatin 25:23.

Përzgjedhësi Lorik Ilazi dhe stafi i tij treguan fleksibilitet dhe aftësi për të menaxhuar situatat e vështira, duke u siguruar që ekipi të dilte triumfues në fund.

Ky rezultat i jashtëzakonshëm është një dëshmi e punës së palodhshme dhe përkushtimit të ekipit dhe stafit. Nën dirigjimin e përzgjedhësit Lorik Ilazi, kombëtarja e vajzave në volejboll ka treguar se është gati për sfidat e ardhshme në kualifikimet e CEV EuroVolley.

Përgëzime të veçanta shkojnë për të gjitha lojtarët që dhanë maksimumin dhe për Lorik Ilazin, i cili ka ndërtuar një ekip të fortë dhe të bashkuar.

Kjo fitore është vetëm fillimi i asaj që pritet të jetë një rrugë e suksesshme për Kosovën në arenën ndërkombëtare të volejbollit.

KORÇA, NDALESA E FUNDIT E KOSOVËS NË PËRGATITJET PËR EUROVOLLEY

6 Gusht 2024

Qyteti i volejbollit, Korça, do të jetë ndalesa e fundit e Kombëtares së Kosovës në volejboll, në konkurrencën e vajzave, në përgatitjet për paraqitjet e tyre në kualifikimet për CEV EuroVolley.

Të martën, Kombëtarja jonë zhvilloi stërvitjen e parë në grumbullimin gjatë së cilit do të pasurohet fondi i orëve të punës dhe gjithashtu komponimi sa më i mirë i skuadrës. Në një ambient të mirë dhe me një atmosferë fantastike mes grupit, si asnjëherë më parë, po vazhdohet me rekord grumbullimesh, për të synuar një rezultat sa më të mirë.

Në një grup të fortë, Kosova do të kërkojë të lërë gjurmë në kualifikimet për CEV EuroVolley. Në konkurrencën e femrave, Kosova është në grup me Rumaninë dhe Kroacinë, dy kundërshtarë shumë të fortë.



Volejbollistet tona do të hapin kampanjën e kualifikimeve me ndeshjen kundër Kroacisë, që do të zhvillohet në shtëpi më 17 gusht 2024, nga ora 20:00 në Gjilan.

KOSOVA, DY MIQËSORE ME MAQEDONINË E VERIUT

Kombëtarja e Kosovës në volejboll për vajza, gjatë grumbullimit final në Korçë, do të zhvillojë dy miqësore me Maqedoninë e Veriut.

Në palestrën e sporteve “Tamara Nikolla” në Korçë, Kosova miqësoren e parë e zhvillon të enjten më 8 gusht në orën 20:00, ndërsa menjëherë të premten do të jetë në program edhe miqësorja e dytë ndaj Maqedonisë së Veriut, nga ora 13:00.

FVK u uron suksese vajzave tona në përgatitjet për kualifikimet e CEV EuroVolley.

“DARDANËT” NË TURNEUN E STRUMICËS, PËR FINALEN E PËRGATITJEVE

7 Gusht 2024

Kombëtarja e Kosovës në volejboll, sot është nisur drejt Strumicës në Maqedoninë e Veriut, ku do të jetë pjesë e turneut të 48-të "Branko Hadziiljoski – Chajka“.

Djemtë e drejtuar nga përzgjedhësi Martin Nemec, do ta shfrytëzojnë këtë turne për të testuar formën e ekipit me dy kombëtaret tjera që janë pjesë e kësaj gare, Maqedoninë e Veriut dhe Izraelin.



Të enjten, Kosova luan me nikoqirin, Maqedoninë e Veriut, kurse të premten zhvillon ndeshjen me Izraelin.

Miqësoret do të japin një pasqyrë më reale të formës së skuadrës, në prag të ndeshjeve kualifikuese për CEV EuroVolley, të cilat Kosova i zhvillon më 17 gusht.

KOSOVA E MBYLL TESTIN E PARË NË MIQËSORE

7 Gusht 2024

Kombëtarja e djemve ka zhvilluar ndeshjen e parë në kuadër të fazës testuese kundër Maqedonisë së Veriut, në turneun që po mbahet në Strumicë.

Përzgjedhësi Martin Nemec ka provuar të gjitha skemat duke u dhënë hapësirë të gjithë volejbollistëve dhe duke ofruar kombinime të shumta, në mënyrë që kjo miqësore të shfrytëzohet në maksimum.



Prandaj, rezultati mbase u la në planin e dytë, në përpjekje për të krijuar një kimi sa më të mirë dhe për të nxjerrë formacionin ideal.

Maqedonia e Veriut e fitoi ndeshjen me rezultat 3:0 (25:22; 25:7; 25:19).

Të premten, Kosova zhvillon ndeshjen e dytë kundër Izraelit, që gjithashtu konsiderohet si një mundësi e mirë për të vlerësuar formën e secilit volejbollist në radhët e "Dardanëve".

KOSOVA MPOSHTET NGA IZRAELI

Në ndeshjen e dytë të turneut të 48-të memorial "Branko Hadziiljoski – Chajka" Kosova u mposht nga Izraeli me rezultat 3-0 në sete, duke vazhduar kërkimin për formacionin ideal për kualifikimet e CEV EuroVolley.

Pas humbjes së djeshme ndaj Maqedonisë së Veriut, kjo ndeshje i ofroi përzgjedhësit Martin Nemec mundësinë të testojë formula dhe kombinime të ndryshme në kërkim të formacionit më të mirë.

Seti i parë u karakterizua nga një përballje e fortë në fillim, me Kosovën që mbajti një ritëm të lartë deri në mes të setit. Megjithatë, Izraeli arriti të marrë kontrollin në fund, duke fituar setin 25-19. Lojtarët tanë u përpoqën ta rikthenin epërsinë, por kundërshtarët ishin më të saktë në pikat vendimtare.

Seti i dytë tregoi një dominim të qartë të Izraelit, që nga fillimi deri në fund. Kosova pati vështirësi në mbrojtje dhe në organizimin e sulmeve, duke humbur setin me një diferencë të madhe prej 25-13. Ky set ishte një mundësi për Nemec që të eksperimentonte me ndryshime taktike, por Izraeli mbeti i pakapshëm.

Seti i tretë ishte më i balancuar, me Kosovën që tregoi shenja të rikuperimit dhe luftoi deri në fund. Megjithatë, Izraeli arriti ta mbyllë setin 25-20, duke siguruar fitoren e përgjithshme. Pavarësisht humbjes, ky set ofroi një pasqyrë të qartë për përmirësimet e nevojshme dhe opsionet taktike për të ardhmen.

Kjo ishte ndeshja e dytë e Kosovës në turne dhe përzgjedhësi Nemec shfrytëzoi mundësinë për të kërkuar kombinimet më të mira për kualifikimet e ardhshme në CEV EuroVolley.

VOLEJBOLLI, PJESË E PROJEKTIT "SPORTI NË SHKOLLA"

7 Gusht 2024

Në vitin e dytë të implementimit të tij, projekti shtetëror "Sport në shkolla" i realizuar nga Federata e Sportit Shkollor, pritet të zgjerohet edhe me sportin e volejbollit.

Ky projekt, që vjen në partneritet me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë si dhe Ministrinë për Kulturë, Rini dhe Sport, pritet që nga viti i ri shkollor, pas shahut dhe basketbollit, të përfshijë edhe volejbollin si pjesë e implementimit nëpër shkollat e gjitha rajoneve të Kosovës.



Pas takimeve intensive mes presidentit të FVK-së Bahri Gjinovci dhe sekretarit të përgjithshëm Valon Nikqi, me kryetarin e FSHSK-së Adrian Telaku dhe koordinatorët e projektit Dren Marseli dhe Arbisa Shefkiu, pritet që në fazën finale të përgatitjeve për implementim, të zbulohen detajet e mënyrës së realizimit të këtij projekti.

Përfshirja e volejbollit në projektin "Sport në shkolla" është një lajm i shkëlqyer për të rinjtë dhe të rejat, të cilët do të përfitojnë shumë përmes sportit të rrjetës.

BEACH-VOLLEY: KOSOVA I MËSON RIVALËT NË BVA U22

8 Gusht 2024

Në Novo Selo të Maqedonisë së Veriut do të mbahet Kampionati Ballkanik U22 i BVA në beach volley, në të cilin Kosova paraqitet me dy ekipe.

Në ekipin e djemve, do të përfaqësohemi nga:

- Erind Qalaj

- Donat Gërguri

- Trajneri Fatlum Hajrizi

Ekipi i vajzave përbëhet nga:

- Melirona Avdullahu

- Yllka Jashari

- Trajneri Edon Ibrahimi

Te djemtë, Kosova garon në Grupin A, së bashku me Maqedoninë e Veriut 1, Rumaninë 2 dhe Greqinë.

Te vajzat, Kosova është pjesë e grupit B së bashku me Rumaninë 2 dhe Turqinë.

Të premten, djemtë nga ora 10:00 luajnë kundër Rumanisë 2, kurse vajzat nga ora 17:45 ndaj Turqisë

VAJZAT ME PARAQITJE MBRESËLËNËSE NË MIQËSOREN E PARË

8 Gusht 2024

“Dardanet” kanë zhvilluar ndeshjen e parë miqësore, në kuadër të grumbullimit në Korçë.

Volejbollistet tona e zhvilluan miqësoren në 5 sete, duke pësuar nga kombetarja e Maqedonisë së Veriut në "Tamara Nikolla" të Korçës, me rezultat 3:2.

Pas fitores së dy seteve të para nga volejbollistet maqedonase (18:25; 20:25), Kosova u rikthye fuqishëm duke barazuar rezultatin në 2:2 në sete, përmes periudhës së tretë dhe të katërt (25:21; 25:18).



Në tie-break, Maqedonia e Veriut arriti të triumfojë me rezultat 15:13, por ky rezultat nuk e zbeh paraqitjen e jashtëzakonshme dhe kompaktësinë e skuadrës kosovare, në prag të kualifikimeve për CEV EuroVolley.

KOSOVA FITON BINDSHËM NDAJ MAQEDONISË SË VERIUT

9 Gusht 2024

Kosova ka shënuar një fitore bindëse ndaj Maqedonisë së Veriut në ndeshjen miqësore të zhvilluar në “Tamara Nikolla” në Korçë, duke triumfuar me rezultat të pastër 3-0.

Në setin e parë, Kosova e nisi ndeshjen me një ritëm të lartë, duke e mbajtur kontrollin dhe duke e fituar setin me rezultat 25-17. Lojtarët tanë treguan një organizim të shkëlqyer dhe nuk i lanë hapësirë kundërshtarëve të krijojnë presion.

Në setin e dytë, Kosova vazhdoi dominimin, duke i shfrytëzuar në maksimum gabimet e kundërshtarëve dhe duke rritur epërsinë me një fitore të thellë 25-15. Ekipi tregoi disiplinë taktike

dhe forcë në mbrojtje, duke e bërë të vështirë çdo tentativë të Maqedonisë së Veriut për të rikthyer balancën.



Seti i tretë ishte edhe më mbizotërues, ku Kosova e përfundoi ndeshjen me një rezultat të qartë 25-13. Ky set përmbylli një performancë të shkëlqyer, duke dëshmuar se ekipi është në formë të lartë dhe i gatshëm për sfidat e ardhshme.

ISTREF ELEZAJ NË CEV U20 KAMPIONATIN EVROPIAN

9 Gusht 2024

Istref Elezaj është nominuar për të ndarë drejtësinë në CEV U20 Kampionatin Evropian të Volejbollit për femra, i cili po mbahet nga 5 deri më 17 gusht 2024 në Bullgari dhe Irlandë.

Kampionati organizohet në dy grupe, ku njëri grup do të zhvillohet në Bullgari dhe tjetri në Irlandë.

Elezaj është deleguar për të referuar ndeshjet e grupit në Irlandë, ku do të garojnë Italia, Irlanda, Çekia, Polonia, Portugalia, Finlanda, Ukraina dhe Serbia.

Dy ekipet më të mira nga ky grup do të kualifikohen për gjysmëfinale, ku do të përballen me dy ekipet më të mira nga grupi në Bullgari.



"Ky nominim është një vlerësim i rëndësishëm për Elezajn, duke qenë hera e parë që ai referon në një kampionat evropian, pas disa ndeshjeve të suksesshme të gjykuara në kualifikime. Për më shumë se 10 ditë, ai do të ketë mundësinë të referojë ndeshje të ekipeve me volejboll cilësor, duke shtuar përvojën e tij në nivelet më të larta të garave ndërkombëtare.

Ky emërim vjen pas vlerësimeve pozitive të marra nga ndeshjet e gjykuara në Challenge Cup dhe Silver League." - ka thënë Elezaj.

DJEMTË E FITOJNË NDESHJEN E PARË NË KAMPIONATIN BALLKANIK

7 Gusht 2024

Dyshja kosovare e beach volley, Erind Qalaj dhe Donat Gërguri, të drejtuar nga trajneri Fatlum Hajrizi, e kanë shënuar fitoren e parë në Kampionatin Ballkanik U22.

BVA Kampionati Ballkanik U22 po mbahet në Novo Selo të Maqedonisë së Veriut dhe Kosova paraqitet me dy ekipe, atë të djemve Qalaj/Gërguri dhe të vajzave Avdullahu/Jashari.

Kosova fitoi 2:0 ndaj Rumanisë 2, me rezultat në sete 21:14 dhe 21:19.

Te djemtë, Kosova garon në Grupin A, së bashku me Maqedoninë e Veriut 1, Rumaninë 2 dhe Greqinë.



Te vajzat, Kosova është pjesë e Grupit B, së bashku me Rumaninë 2 dhe Turqinë.

Sot vajzat, nga ora 17:45, luajnë ndaj Turqisë, në ndeshjen e parë të kampionatit.

QALAJ/GËRGURI ME FITOREN E DYTË

Në ndeshjen e dytë të grupit, dyshja kosovare Qalaj/Gërguri ka shënuar një fitore të rëndësishme 2-1 kundër ekipit të parë të Maqedonisë së Veriut.

Në setin e parë, Maqedonia e Veriut e nisi fuqishëm dhe e kontrolloi lojën, duke e mposhtur Kosovën me rezultat 21-13. Pavarësisht përpjekjeve, ekipi ynë nuk arriti ta kapërcejë epërsinë e kundërshtarëve.



Seti i dytë tregoi një kthesë të madhe për Qalaj dhe Gërguri. Duke u përmirësuar në sulm dhe duke treguar një mbrojtje të fortë, ata arritën ta barazojnë ndeshjen me një fitore 21-17, duke e rikthyer besimin për fitoren.

Seti i tretë dhe vendimtar ishte një betejë e vërtetë, por Kosova mbizotëroi në momente kyçe, duke e fituar me rezultat 15-8. Lojtarët tanë treguan qetësi dhe përqendrim maksimal, duke siguruar kështu fitoren e dytë në grup dhe duke i bërë një hap të madh drejt kualifikimit. Pas kësaj fitoreje, djemve tanë u mbetet vetëm edhe ndeshja ndaj Greqisë, e fundit në grup, për të vazhduar garën në raundin eliminues.

AVDULLAHU/JASHARI ME FITORE NË BALLKANIKUN E BEACH VOLLEY

10 Gusht 2024

Dyshja kosovare në konkurrencën e vajzave, Melirona Avdullahu dhe Yllka Jashari, të drejtuara nga trajneri Edon Ibrahimi, kanë arritur fitoren e tyre të parë në BVA U22 Kampionatin Ballkanik në beach volley, duke mposhtur ekipin e dytë të Rumanisë me rezultat 2-0.



Në setin e parë, vajzat tona e nisën fuqishëm ndeshjen, duke treguar një organizim të shkëlqyer dhe një lojë të sigurtë. Me një sulm të saktë dhe një mbrojtje të pathyeshme, ato arritën të fitojnë setin me rezultat bindës 21-13. Performanca e tyre e lartë u reflektua në shkathtësinë për të kontrolluar ritmin e lojës dhe për të përfituar nga gabimet e kundërshtareve.

Seti i dytë ishte më i balancuar, me Rumaninë që u përpoq të kthehej në lojë, por Avdullahu dhe Jashari qëndruan të vendosura. Ato arritën ta ruajnë epërsinë dhe ta mbyllin setin me rezultat 21-16, duke siguruar kështu fitoren e përgjithshme 2-0. Ky set dëshmoi qëndrueshmërinë e tyre dhe aftësinë për të menaxhuar presionin, veçanërisht në fazat kritike të ndeshjes. Kjo është fitorja e parë e vajzave tona në këtë kampionat, dhe ato tashmë kanë siguruar një vend në çerekfinale. Ndeshja çerekfinale do të zhvillohet sonte në orën 21:00, ku Kosova do të përballet me Bosnje e Hercegovinën. Ekipi Avdullahu/Jashari do të kërkojë të vazhdojë me këtë formë të shkëlqyer, duke synuar një vend në podium.

KOSOVA E MBYLL AVENTURËN NË ÇEREKFINALE

Dyshja kosovare Erind Qalaj dhe Donat Gërguri përfunduan garën e tyre në BVA Kampionatin Ballkanik në beach volley U22, pasi u mposhtën në çerekfinale nga ekipi i parë i Rumanisë me rezultat 2-0 (21:8, 21:19). Në setin e parë, Kosova pati një paraqitje të dobët, duke u përballur me një ekip rumun që shfrytëzoi çdo mundësi për të marrë avantazhin. Seti përfundoi me rezultat të thellë 21-8 në favor të Rumanisë, duke lënë pak hapësirë për reagim nga dyshja jonë. Në setin e dytë, Kosova tregoi një lojë shumë më të mirë, duke udhëhequr me rezultat 18-13 dhe duke i dhënë shpresa për të barazuar ndeshjen. Megjithatë, përvoja më e madhe e rumunëve luajti rol vendimtar në fund, dhe ata arritën ta përmbysin rezultatin, duke e fituar setin 21-19 dhe kështu mbyllën ndeshjen në favor të tyre. Megjithëse djemtë nuk arritën të kalojnë më tej, performanca në setin e dytë dëshmoi për përmirësimet dhe potencialin e ekipit tonë për garat e ardhshme.

VAJZAT E MBYLLIN GARËN NË ÇEREKFINALE

Dyshja kosovare në konkurrencën e vajzave, Melirona Avdullahu dhe Yllka Jashari, përfunduan rrugëtimin e tyre në BVA Kampionatin Ballkanik U22 në beach volley, pasi u mposhtën në një ndeshje dramatike kundër Bosnjë e Hercegovinës me rezultat 2-1.

Seti i parë filloi mjaft mirë për vajzat tona, të cilat arritën të kontrollojnë ritmin e lojës dhe të fitojnë me rezultat 21-17.

Avdullahu dhe Jashari treguan përqendrim të lartë dhe shfrytëzuan gabimet e kundërshtareve për të marrë epërsinë.

Në setin e dytë, Bosna reagoi fuqishëm, duke u rikthyer në lojë me një mbrojtje të fortë dhe një sulm të mirëorganizuar. Pavarësisht përpjekjeve të vajzave tona për të mbajtur ritmin, Bosnja arriti të fitojë setin me rezultat 21-17, duke e barazuar ndeshjen. Seti i tretë ishte vendimtar dhe tejet i ngushtë. Kosova e filloi mirë, por Bosnja shfrytëzoi përvojën e saj dhe arriti të përmbysë rezultatin,

duke fituar 18-16 dhe duke mbyllur kështu ndeshjen në favorin e tyre. Pavarësisht rezultatit, performanca e vajzave kosovare në këtë kampionat ishte e admirueshme. Ato luftuan me zemër dhe shfaqën një lojë të bukur në çdo ndeshje.

MË 17 GUSHT, TË GJITHË NË MBËSHTETJE TË KOMBËTAREVE

Të gjitha rrugët, më 17 gusht dërgojnë drejt Pallatit të Sporteve "Bashkim Selishta-Petriti". Vajzat e djemtë e Kombëtares së Kosovës, gati për spektaklin të cilin s'duhet ta humbisni as ju. Më 17.08.2024, nga ora 17:00, Kombëtarja e djemve ndeshjet me Letoninë. Të njëjtën mbrëmje, nga ora 20:00, vajzat e Kombëtares sfidohen nga Kroacia. Bëhuni zëri e fuqia e "Dardanëve"





VAJZAT E KOMBËTARES E MBYLLIN GRUMBULLIMIN NË KORÇË, GATI PËR KROACINË

13 Gusht 2024

Kombëtarja e vajzave mbylli kampin në Korçë dhe nesër do të vendoset në Gjilan për ndeshjen me Kroacinë.

Përgjatë këtyre ditëve, përzgjedhësi Lorik Ilazi i asistuar nga Ylli Kadriu, Vlora Berisha, Albin Rexhepi dhe mbështetjen e Ervin Meqikukiqi, si dhe të team-menaxherit Agron Istogu, ka realizuar në plotmëri programin e përgatitjeve.



Për kampin në Korçë, e falenderojmë Federatën Shqiptare të Volejbollit, Bashkinë e Korçës dhe Klubin Shumësportesh Skënderbeu për kushtet dhe mikpritjen.

Kombëtaren në ditën përmbyllëse të grumbullimit e vizitoi edhe Presidenti i FVK-së, Bahri Gjinovci, i cili shfrytëzoi mundësinë t'i përgëzonte stafin e vajzat, për përkushtimin, duke u uruar suksese në kualifikimet e CEV EuroVolley.

KOSOVA E FILLON ME HUMBJE KAMPANJËN E KUALIFIKIMEVE EVROPIANE

17 Gusht 2024

Në ndeshjen e parë të kualifikimeve ndaj Letonisë, Kosova u mposht me rezultat 3-0, në sete 14:25, 19:25 dhe 17:25. Seti i parë ishte më i zbehti për Kosovën. Ekipi nuk arriti ta gjejë ritmin e duhur dhe ishte i ngathët në mbrojtje, duke i dhënë Letonisë një epërsi të qartë, me çka ndikoi që mysafirët të shënojnë lehtë pikët dhe të mbyllë setin me një diferencë të konsiderueshme prej 11 pikësh. Në setin e dytë, Kosova tregoi një përmirësim të dukshëm, duke arritur të kalojë në epërsi deri në tre pikë, në periudhën kur rezultati ishte 13:10.

Kjo periudhë e lojës dëshmoi përkushtimin dhe luftën e skuadrës kosovare, duke treguar se mund të rivalizojë. Megjithatë, në gjysmën e dytë të setit, Letonia rikuperoi shpejt dhe mori kontrollin, duke e përmbyllur setin në favorin e saj me një rezultat 19:25.



Seti i tretë ishte një përpjekje e fortë nga Kosova për të rikthyer ndeshjen, por Letonia përsëri doli më e suksesshme. Kosovarët arritën të mbajnë një ritëm të mirë dhe të qëndrojnë afër rezultatit për pjesën më të madhe të setit, por në fund mungesa e eksperiencës dhe cilësisë bëri që Letonia ta mbyllë setin me rezultatin 17:25, duke siguruar kështu fitoren e saj të tretë kundër Kosovës.

Kjo ishte fitorja e tretë e letonezëve përballë Kosovës, pas dy fitoreve të mëparshme të regjistruara në vitin 2018. Kosova do të zhvillojë ndeshjen e saj të radhës më 28 gusht 2024, si mysafir ndaj Sllovakisë. Pavarësisht humbjes, përballë një skuadre shumë më cilësore, paraqitja në secilin prej setave dha sinjale të mira për Kombëtaren. Pas gjashtë vjet mungesë në prezantimet zyrtare në garat ndërkombëtare, kjo përballje tregoi se Kosova po përmirësohet dhe mund të ofrojë më shumë në të ardhmen.

VASHAT PËSOJNË NGA KROACIA NË NDESHJEN E PARË KUALIFIKUESE

17 Gusht 2024

Në përballjen e parë ndonjëherë ndaj Kroacisë në volejbollin e femrave, Kosova u ndesh me një nga favoritët e kualifikimeve për CEV EuroVolley, dhe pavarësisht humbjes 3-0 (25:16; 25:18; 25:8), e tregoi shpirtin luftarak dhe përkushtimin për të përfaqësuar vendin denjësisht në arenën ndërkombëtare. Kosova filloi ndeshjen me një përpjekje të fortë, duke sfiduar kundërshtarin e fortë kroat.Edhe pse rezultati përfundimtar i setit ishte 16:25 në favor të Kroacisë, vajzat tona treguan rezistencë dhe disiplinë, duke luftuar për çdo pikë.

Kroacia arriti të përfitojë nga përvoja e saj dhe të marrë kontrollin e setit, por Kosova dëshmoi se mund të qëndrojë konkurruese në faza të ndryshme të lojës. Në setin e dytë, Kosova tregoi përmirësim të dukshëm. Vajzat arritën të krijojnë momente të mira dhe të sfidojnë Kroacinë deri në fund të setit. Me një përqendrim të lartë dhe energji të madhe, ato qëndruan afër në rezultat, duke e mbyllur setin me 18:25. Ky set ishte dëshmi e rritjes së vazhdueshme të ekipit dhe aftësisë së tyre për të rivalizuar edhe kundër ekipeve më të forta.

Seti i tretë ishte më i vështiri për Kosovën. Kroacia shfrytëzoi përvojën dhe forcën e saj për të dominuar setin dhe për të siguruar një fitore bindëse me rezultatin 9:25. Pavarësisht rezultatit, vajzat tona nuk u dorëzuan dhe vazhduan të luftojnë deri në fund, duke treguar qëndrueshmëri dhe shpirt të lartë ekipi. Përballja ndaj Kroacisë, një nga ekipet më të forta në këtë grup, ishte një sfidë e madhe për Kosovën. Megjithatë, kjo ndeshje ofroi mësime të vlefshme dhe sinjale pozitive për përmirësimin e mëtejshëm.



Kombëtarja jonë dëshmoi se ka potencial dhe është në rrugën e duhur për të arritur rezultate të mira në të ardhmen.Kosova do të zhvillojë ndeshjen e saj të radhës si mysafire ndaj Rumanisë, një tjetër kundërshtar i fortë në grup. Federata e Volejbollit të Kosovës (FVK) i inkurajon vajzat tona që të vazhdojnë përpjekjet e tyre dhe të mbajnë kokën lart, pasi çdo përballje është një hap përpara drejt qëllimeve të tyre afatgjata.

KOMBËTARJA E DJEMVE BËHET GATI PËR SLLOVAKINË

20 Gusht 2024

Pas ndeshjes kundër Letonisë, Kombëtarja e djemve ka vazhduar përgatitjet në palestrën Imperium, afër Prishtinës. Grumbullimi ka vijuar me intensitet, dhe skuadra tashmë e ka përfunduar fazën e rigjenerimit, duke e kthyer të gjithë fokusin te ndeshja e radhës kundër Sllovakisë. Trajneri sllovak i Kombëtares së Kosovës, Martin Nemec, është një njohës i mirë i mentalitetit dhe stilit të lojës së kundërshtarit tonë të radhës, Sllovakisë, prej nga ai e ka origjinën.



Me përgatitjen dhe njohuritë e tij, skuadra është e vendosur të paraqitet me performancën më të mirë në këtë përballje të rëndësishme.

Ndeshja Sllovaki - Kosovë do të zhvillohet më 28 gusht 2024 në qytetin Nitra.

VAJZAT E KOMBËTARES VAZHDOJNË PËRGATITJET

20 Gusht 2024

Pas përballjes së parë ndaj Kroacisë, Kombëtarja e vajzave në volejboll ka vazhduar me përkushtim përgatitjet për ndeshjen e radhës. Ekipi po punon intensivisht në pallatin e sporteve "Bashkim Selishta-Petriti" qytetin e Gjilanit, duke përmirësuar çdo aspekt të lojës dhe kanalizuar energjinë nga ndeshja e kaluar drejt suksesit në sfidën e ardhshme.

Në kuadër të kualifikimeve për CEV EuroVolley, ndeshja e dytë do të jetë një test i rëndësishëm për vajzat tona, të cilat do të përballen me Rumaninë si mysafire.



Atmosfera në kampin e Kosovës është jashtëzakonisht pozitive, dhe fryma e bashkëpunimit dhe optimizmit qëndron në zemër të përgatitjeve të tyre. Kjo energji pritet të reflektohet në një paraqitje dinjitoze në fushë.

Vajzat janë të vendosura të japin maksimumin dhe të përfaqësojnë me krenari vendin e tyre në këtë sfidë të rëndësishme.

Ndeshjen me Rumaninë, "Dardanet" do ta zhvillojnë në qytetin Blaj, më 29 gusht 2024.

MARRËVESHJE E RE KOSOVË-SHQIPËRI

23 Gusht 2024

Federata e Volejbollit e Kosovës dhe ajo e Shqipërisë kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi të rëndësishme, e cila do t'u mundësojë klubeve nga të dyja vendet të aktivizojnë një lojtar si vendor në Superligën e Kosovës dhe Superligën e Shqipërisë.

Ky lojtar do të llogaritet si lojtar vendor dhe secili klub do të ketë të drejtë të aktivizojë vetëm një të tillë.



Marrëveshja do të hyjë në fuqi nga viti 2025 dhe gjatë javëve në vijim do të zbulohen detaje të mëtejshme rreth implementimit të saj.

Ajo u arrit gjatë takimit të Asociacionit Ballkanik të Volejbollit (BVA), e udhëhequr nga presidenti z. Erlind Pëllumbi e cili u mbajt në Napoli të Italisë.

Në të njëjtin qytet, nesër pritet të fillojë punimet edhe Asambleja e Zgjedhore e CEV-it, ku Kosova përfaqësohet nga presidenti Bahri Gjinovci dhe sekretari i përgjithshëm Valon Nikqi.

KROATI SIKIRIÇ ZGJEDHET KRYETAR I CEV-it

24 Gusht 2024

Delegatë nga 53 Federata Kombëtare (51 të pranishme dhe 2 tjera që janë përfaqësuar përmes delegimit të votës), e kanë zgjedhur Roko Sikiriç si president të ri të CEV për mandatin 2024-2028. Kroati Sikiriç fitoi në në konkurencë edhe me 3 kandidatë tjerë, duke marrë 36 vota, në favor të tij.



Asambleja zgjedhore e shumëpritur e CEV u mbajt të shtunën, më 24 gusht, në Castel Nuovo, një kështjellë ikonike në Napoli, Itali. Në këtë asamble, volejbolli kosovar u përfaqësua nga presidenti Bahri Gjinovci dhe sekretari i përgjithshëm Valon Nikqi.

Gjinovci dhe Nikqi e kanë përgëzuar presidentin e ri të CEV, Roko Sikiriç, duke i uruar fat dhe suksese në mandatin e tij në krye të shtëpisë evropiane të volejbollit.

KOMBËTARJA NISET PËR NË SLLOVAKI

27 Gusht 2024

Kombëtarja e Kosovës në volejboll, në konkurencën e djemve, është nisur paraditen e së martës në drejtim të Sllovakisë.

Atje, saktësisht në qytetin Nitra, Kosova e zhvillon ndeshjen e dytë të kualifikimeve për CEV EuroVolley.



Dueli me sllovakët, është një tjetër sfidë serioze, pas asaj me Letoninë më 17 gusht në Gjilan.

Ndeshja Sllovaki-Kosovë zhvillohet në 28 gusht 2024 në qytetin Nitra.

FVK i uron suksese djemve dhe shtabit teknik të Kombëtares.

KOMBËTARJA E VAJZAVE NISET PËR RUMANI

27 Gusht 2024

Pas sfidës ndaj Kroacisë, “Dardanet” janë nisur të martën drejt Rumanisë, ku do të zhvillojnë ndeshjen e dytë të kualifikimeve.



Vashat tona, pas grumbullimit të fundit që erdhi menjëherë pas ndeshjes me Kroacinë, e kanë ruajtur ritmin dhe synojnë të rrisin standardin në paraqitjen e tyre në takimin me Rumaninë.

Ndeshja Rumani-Kosovë zhvillohet më 29 gusht 2024, nga ora 18:00 në palestrën Polivalenta Alba Blaj.

FVK u uron shumë sukses vajzave dhe shtabit teknik, në sfidën me ekipin rumun.

KOSOVA ARRIN NË RUMANI, ZHVILLON STËRVITJEN E PARË

28 Gusht 2024

Kombëtarja e Kosovës në volejboll ka mbërritur në Rumani, ku ka zhvilluar stërvitjen e parë në prag të ndeshjes së dytë të kualifikimeve për CEV EuroVolley.

Pas përballjes së tyre të parë kundër Kroacisë më 17 gusht në Gjilan, skuadra është e gatshme të vazhdojë garën në këtë kompeticion të rëndësishëm.



Atmosfera brenda grupit të Kombëtares është jashtëzakonisht pozitive, me lojtaret që tregojnë motivim të lartë dhe besim për ndeshjen e radhës.

Të gjithë janë të përqendruar për të dhënë maksimumin në këtë sfidë të rëndësishme dhe për të përfaqësuar me dinjitet Kosovën.

Ndeshja Rumani-Kosovë, zhvillohet të enjten nga ora 18:00 në Blaj të Rumanisë.

KOSOVA MPOSHTET NË SLLOVAKI

28 Gusht 2024

Kosova ka pësuar humbje 3-0 ndaj Sllovakisë në ndeshjen e zhvilluar sot në City Hall Nitra, Sllovaki, si pjesë e fazës kualifikuese për CEV EuroVolley.

Setet përfunduan me rezultatet 25-21, 25-14, dhe 25-9, duke treguar një dominim të ekipit vendas.

Kjo ishte ndeshja e dytë për Kombëtaren e Kosovës, pas përballjes së tyre me Letoninë në Gjilan.

Pavarësisht rezultatit, Kosova pati një performancë dinjitoze, me kapitenin Gazmend Husaj që u dallua si MVP i ndeshjes, duke shënuar plot 17 pikë.



Ekipi i Kosovës do të vazhdojë të përgatitet për ndeshjet e ardhshme, duke u fokusuar në përmirësimin e performancës dhe përfaqësimin dinjitoz të vendit në skenën ndërkombëtare.

Ndeshjen e rradhës, Kosova e pret pikërisht Sllovakinë.

KOSOVA MPOSHTET NË RUMANI

29 Gusht 2024

Kombëtarja e vajzave të Kosovës ka pësuar humbje në ndeshjen e dytë të fazës kualifikuese të CEV EuroVolley, duke u mposhtur nga Rumania me rezultat 3-0 në setet e zhvilluara në Polivalenta Alba Blaj. Seti i parë filloi me dominim të qartë nga ana e Rumanisë.

Vajzat e Kosovës u përballën me një sulm të fuqishëm dhe të mirëorganizuar nga kundërshtaret, që rezultoi në një rezultat të thellë prej 25-13. Rumania shfrytëzoi çdo mundësi për të mbajtur presionin ndaj Kosovës, e cila nuk arriti të gjejë ritmin e duhur në këtë set.



Seti i dytë ishte më konkurrues, me Kosovën që arriti të përmirësojë mbrojtjen dhe të ngushtojë diferencën në disa momente të lojës. Megjithatë, Rumania vazhdoi të jetë e pandalshme, duke përfunduar setin me rezultatin 25-16.

Pavarësisht përpjekjeve, Kosova nuk arriti të përfitojë nga momentet e tyre të mira, dhe kjo u reflektua në rezultatin e setit. Seti i tretë filloi me një entuziazëm të ri për Kosovën, por Rumania tregoi edhe një herë fuqinë e saj. Seti përfundoi me rezultat 25-14, duke vulosur kështu fitoren e pastër të Rumanisë me 3-0 në këtë ndeshje.

Kjo ishte ndeshja e dytë e Kosovës në fazën kualifikuese, pas përballjes me Kroacinë.

Pavarësisht humbjes, vajzat e Kosovës vazhdojnë të punojnë fort dhe të përgatiten për sfidat e ardhshme.

20 Shtator 2024

Valon Nikqi

Sekretar i Përgjithshëm